

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 21. 9.2006**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 21.09.2006.god.**

SHTATOR-SEPTEMBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës z. Agim Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Legjislativ për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë
4. Rishqyrtimi i rekomandimit të Panelit të Vegantë lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar 6+ në Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

DNEVNI RED

1. Ushqanjë dnevnoq reda,
2. Interpelanca premijera Kosova gadin Agim Çeku, na zahiev Parlamentarne grupe PDK
3. Razmatranje preporuke zakonodavne Komisije za usvajanje liste kandidata za sudije i tuzioca.
4. Ponomo razmatranje preporuke posebnog panela u vezi zakona o upotrebi jezika.

KRYETARI – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryeministër Çeku, mirë se keni ardhur në seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës.

Në sallë momentalisht janë 95 deputetë që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Rendin e ditës me materiale i keni marrë më parëherët, por ndërkohë e kemi një kërkesë nga Grupi 6+ që ka ardhur para seancës.

Duke marrë parasysh 13 pikat e standardeve prioritare, të rekomanduara nga Grupi i Kontaktit dhe momentin e rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës, ju lusim të krijohet mundësi që në Kuvendin e Kosovës edhe një herë të rishqyrtohet amendamenti i Panelit në lidhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

Është i nënshkruar nga kryetari i grupit 6+ z. Mahir Jakcilar dhe nga deputeti Xhezair Murati.

Që në fillim të seancës më lejoni t'jua përkujtoj një çështje të veçantë. Në seancën e kaluar mosaprovimi i amendamentit në Ligjin për gjuhët sipas rekomandimit të panelit, është pritur keq, është pritur si zhgënjim dhe me shumë reagime nga radhët e miqve tanë ndërkombëtarë. Jam i bindur se këtë e keni vërejtur edhe ju, ai veprim në fakt mosveprim, i duhur ishte në kundërshtim me përpjekjet e bëra deri më tash nga të gjitha institucionet e përkohshme të Kosovës, nga Kuvendi për plotësimin e standardeve me të cilat synohet t'i tregohet botës se e meritojmë pavarësinë e Kosovës. Pra sot jemi në këtë situatë specifike dhe kërkoj angazhimin dhe kontributin tuaj që të bëjmë një zgjidhje të pranueshme. Siç e dini, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së e ka të drejtën ta thotë fjalën e vet, fjalën e fundit dhe të kompletojë ligjin sipas rekomandimeve të panelit, mirëpo është dëshirë e tyre që këtë gjë të mos e bëjë ai, por ta bëjë Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të kompletohen standardet për Kosovën. Përveç kësaj dita e sotme ka koincidençë me një ngjarje jashtëzakonisht të madhe dhe të rëndësishme për Kosovën-takimi i Këshillit të Sigurimit- në të cilin ishte i pranishëm edhe presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe nesër takimin e Grupit të Kontaktit të cilin e drejton sekretarja e shtetit e SHBA-ve znj., Kondoliza Rajz. Kosova do të jetë temë e këtyre takimeve dhe sigurisht që do të jetë shumë e rëndësishme çfarë lajmi do të marrim nga kjo seancë.

Unë si kryetar i Kuvendit dhe sipas konsultave dhe me pëlqimin e presidentit të Kosovës, me pëlqimin e shefave të grupeve parlamentare edhe me rekomandimet e të gjithë miqve tanë ndërkombëtarë, propozoj ta futim në rend dite këtë pikë dhe natyrisht të votojmë për të.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare të deklarojnë.

Fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka punuar me shumë përkushtim në hartimin dhe miratimin e Ligjit për gjuhët dhe mendojmë se kemi miratuar një ligj të mirë. Pas kërkesës së Grupit të Kontaktit, grupi ynë parlamentar e merr në konsiderim dhe e mbështet që kjo çështje të hyjë në rendin e ditës për shqyrtim. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit, fjalën e ka z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është që kjo çështje të rikthehet në rendin e ditës edhe pse në seancën e kaluar kemi kërkuar dhe kemi thënë dhe kemi votuar pro kësaj kërkesë të panelit për amendamentin përkatës. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Faleminderit z. kryetar. Edhe Grupi Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës pajtohet që kjo çështje të vihet në rend dite.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI - Faleminderit z. kryetar. Edhe Grupi Parlamentar për Integrim është për futjen e kësaj çështjeje në rend dite sërish për shqyrtim duke shprehur keqardhje që kjo nuk ka ndodhur në seancën e kaluar dhe duke shprehur keqardhje njëkohësisht pse po legjitimohet një praktikë e lëshimit pe para presionit të faktorit ndërkombëtar në situatën kur nuk kemi pasur kurrfarë arsyeje që këtë të mos e bënim në seancën e mëparshme. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETEJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryetar. Ne si grup parlamentar edhe në seancën e kaluar jemi deklaruar se amendamenti duhet të kalojë dhe të mos vijë një situatë që të ripërsëritet dhe të kthehet përsëri në Kuvend. Mendojmë që kjo si pikë e rendit të ditës duhet të futet në seancën e sotme edhe të procedohet dhe të kryhet kjo punë e cila pritet prej nesh dhe që ka rëndësi të madhe pikërisht në momentin nëpër të cilin po kalon Kosova, sepse në fakt me mënyra të tilla frikësohem që nuk i mbetet nderi askujt. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar. Unë nuk kam qenë në mbledhje herën e kaluar në Kuvendin e Kosovës, por mendoj se Kuvendi i Kosovës e ka marrë një vendim të drejtë, ndërsa sot po e merr një vendim jo të drejtë. Kjo them, për mendimin tim dhe për subjektin të cilin e përfaqësoj. Dihen kriteret dhe standardet në nivel ndërkombëtar për minoritetet dhe për gjuhët. Por edhe dihet se herën e kaluar atë standard që e ka aprovuar Kuvendi i Kosovës është standardi më i lartë i mundshëm që nuk e ka asnjë vend në botë, ndërkaq është kërkuar prej qarqeve të ndryshme dhe nga qendrat e ndryshme të vendosjes, mirëpo secili përfaqësues i këtyre vendeve në vendet e tyre e kanë një standard shumë më të ulët seqë po e kërkojnë në Kosovë. Dihet standardi real i Kosovës në aspektin e implementimit, prandaj kjo është diçka shumë e pavend dhe e padrejtë.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI - Z. kryetar i Kuvendit, kolegë të nderuar deputetë, me vështrimin procedural kuvendor, Ligji për gjuhët është i kryer dhe kërkesa e Grupit 6+ është një kërkesë politike e tyre, por në kuptimin procedural është vështirë të gjenden mënyra si të rikthehet në Parlament, është punë krejt tjetër dhe duhet të thuhet para të gjithë deputetëve qartë, ne a po punojmë sipas procedurave të Parlamentit apo diskutojmë në një pozicion politik. Nëse ne në Parlament, për hir të situatave politike që kalon Kosova, jemi në gjendje të rimarrim vendime, atëherë kjo është problem tjetër, por duhet të thuhet para këtij Parlamenti dhe opinionit që në kuptimin procedural ky ligj është kryer në

Parlament dhe ne për hir të kërkesave politike, ta zëmë të Grupit të Kontaktit dhe ato kërkesa janë të artikuluar edhe me shkrim. Mund të pranojmë që në Prizren gjuha turke të jetë gjuhë zyrtare. Fundi i fundit ajo edhe është gjuhë zyrtare. Ju faleminderit.

KRYETARI – Fjalën e ka profesor Daci.

DEPUTETI NEXHAT DACI - Z. kryetar i Parlamentit, kryeministër, kolegë deputetë, unë mendoj se kryetari i Parlamentit u desh ta paraqet atë që ishte në Grupin Parlamentar të LDK-së edhe me atë formulim do të shkurtohej rruga dhe do të shihet krejtësisht që deputetët e Kuvendit të Kosovës në atë seancë plenare ,në të cilën unë nuk kam marrë pjesë, në aspektin kushtetues, ligjor dhe procedural kanë kryer një punë të drejtë. Debati në Grupin Parlamentar të LDK-së ishte politikisht shumë i pjekur, profesionalisht të them “okej”. Interpretimet që janë vërejtur kohëve të fundit në shtyp edhe nga përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare nuk ishin as të nivelit politik as parlamentar. Tendenca që të fajsohej pa asnjë dokument Lidhja Demokratike e Kosovës. në veçanti grupi i saj parlamentar, nuk i ndihmon zgjidhjes së problemeve. Ky Parlament ka patur shumë raste të amendamenteve të këtilla në 5 vjetët e kaluar dhe i kemi tejkualuar me një elegancë të unitetit parlamentar dhe politik, prandaj kërkesa e Grupit Parlamentar 6+ ose kërkesa e minoritetit turk, politikisht është e drejtë të hyjë në rend dite. Grupi Parlamentar ishte unanim në këtë, në dy çështje: E para që seanca plenare ka vendosur mbi bazë të kushtetutës, të ligjit dhe të rregullores së saj dhe parlamentarisht është shumë në rregull. E dyta për hir të proceseve politike në të cilat po kalon Kosova, për hir të aktualitetit politik të ditës së sotme, siç e thatë edhe ju z. kryetar, për hir të asaj që edhe kryetari i Kosovës gjendet në Nju-Jork dhe për hir të ruajtjes së avantazhit politik të Kosovës,.Në këtë proces, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta votojë atë amendament, sepse i ndihmon proceset politike dhe stabilizuese. Më lejoni të distancohem nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Jakup Krasniqi. Prej nga e di z. Krasniqi që Grupi Parlamentar i LDK-së ka votuar në tërësi, unë nuk kam qenë në sallë dhe nuk e di që LDK-ja ka votuar dikush ose nuk ka votuar. Prandaj ta ruajmë qëllimin e mirë që e kanë krejt grupet parlamentare dhe që e shprehën, të futet në rend dite ndoshta edhe si pikë e parë e rendit të ditës, ta tejkalojmë ,sepse ne faktikisht e përkrahëm dhe të ecim më tutje. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Daci. Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, i nderuari kryeministër dhe z. deputetë. E thamë për hir tuajin, për hir të së vërtetës dhe të opinionit që na shikon, se Grupi Parlamentar i PDK-së kur në seancën e kaluar ka thënë se jemi pro këtij ligji ,nuk ka votuar nga asnjë formë e presionit që u është bërë Partisë Demokratike, Grupit Parlamentar dhe shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Kemi votuar se kemi qenë dhe jemi të bindur se po e bëjmë një diskriminim pozitiv, po ky Parlament ka bërë shumë votime, ka marrë shumë vendime që kanë qenë të sferës së diskriminimit pozitiv, bile jo edhe vetëm pozitive, prandaj nuk kisha dëshiruar që askush këtu të mos e keqpërdor foltoren për të treguar patriotizmin e vonuar. Ne merremi me politikë, kemi menduar politikisht, kemi vepruar politikisht se jemi të vetëdijshëm, kemi investuar për të ardhur Kosova, prandaj ne e kemi votuar këtë amendament të panelit me të cilin kemi qenë dhe jemi përsëri të bindur se nuk është dashur ta presim as formimin e panelit për këtë amendament. Prandaj është mirë që Parlamenti të mos shfrytëzohet për t’i sulmuar të tjerët dhe nuk di se koalicioni qeverisës , në koalicion edhe me Grupin 6+, se vërtet e ka vënë në lojë pozicionin..... në

Kosovë. Kisha dëshiruar dhe lutur deputetët të mendojnë për interesin politik, proceset që po kalon Kosova dhe ky amendament nuk e dëmton procesin politik, nuk e dëmton as të ardhmen e Kosovës, as të ardhmen e qytetarëve të Kosovës, përkundrazi ne po ja mundësojmë dhe po i japim rast një minoriteti që gjatë këtij procesi ka përkrahur procesin për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Mendoj se këtu kemi obligim ta mbështesim këtë kërkesë të Grupit Parlamentar 6+ dhe posaçërisht të minoritetit turk për qytetin e Prizrenit. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHASRI – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër. Më lejoni që këtë fjalë timen lidhur me çështjen që po e trajtojmë ta filloj duke shprehur sadsifaksion timin të vogël personal dhe një pakënaqësi të madhe në emër të Grupit. Sadsifaksioni personal imi është që në këtë Kuvend erdhi dita kur edhe kryemjeshtrit të ndaljes së mikrofonit iu ndal mikrofonit. Kjo është një mrekulli dhe e di që nuk tingëllon bukur, por sidoqoftë është mirë të gjendet në lëkurën e huaj dhe ta dijë sa është e ngushtë ajo lëkurë. Kurse pakënaqësia ime është që po e bëjmë punën pa nder. Kuvendi i Kosovës punën e bën si organ kolektiv. Të gjithë në këtu kemi dështuar dy herë, pavarësisht kush si ka votuar. Çështja si i trajtojmë problemet dhe me çfarë serioziteti merremi me problemet, e determinon edhe punën e këtij Kuvendi. Unë shpreh keqardhje për të gjithë ata deputetë të cilët nuk kanë qenë në nivelin e përgjegjësisë dhe nuk i kanë kuptuar detyrat që koha i shtron para tyre. Faji është i të gjithëve edhe i atyre që janë në Kryesi të Kuvendit edhe yni që ndoshta e kemi kuptuar, por nuk kemi qenë në gjendje ta përcjellim më tutje mesazhin. Është dashur bashkarisht të ndalemi dhe një punë që duhet ta bëjmë për hir të atyre qytetarëve që jetojnë në Prizren dhe jo për hir të presioneve ta bëjmë me nder dhe me zemërgjërsi, sepse Kosova nuk humb asgjë me të drejta që ua jep të tjerëve. Kosova vetëm rritet me të drejtat që ua jep atyre edhe atë me të drejtat maksimale, të cilat ndoshta nuk do të mund as t'i eksploatojnë. Pra, ajo zemërgushtësi që e kemi manifestuar bashkarisht si Kuvend na ka prurë në situatë që u jemi nënshtruar presioneve nga jashtë, fatkeqësisht presioneve nga jashtë ne po u përshtatemi, prandaj e ndiej një pakënaqësi shumë të madhe, në emër të grupit që sot, pas këtyre presioneve ne e kemi ndryshuar mënyrën e shprehjes lidhur me të njëjtën çështje që dy herat e tjera kemi diskutuar ndryshe.

KRYETARI – Ju faleminderit. Ka deputet që e kërkojnë fjalën ende, por ju lutem është marrë qëndrimi, shefat e grupeve parlamentare u përcaktuan për këtë pikë të rendit të ditës që të futet në rend dite. Të mos e zgjasim më diskutime, fjalën e ka Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar, mua më vjen mirë që është vullneti i të gjitha grupeve parlamentare që sot të votohet për së dyti, pavarësisht nga ndonjë kundërshtim. Unë propozoj, meqë kemi marrë vendim herën e kaluar, të votohet për anulimin e vendimit të marrë në seancën e mëparshme dhe së dyti të votohet për futje në rend të ditës të propozimit të Grupit Parlamentar 6+ dhe pastaj të votojmë dhe të konstatojmë votimin. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Ftoj deputetët të deklarohen se a miratohet rendi i ditës me këtë pikë.

Votojmë tash:

Për71,

Kundër11.

Miratohet propozimi, d.m.th. futet në rend dite. Për këtë propozim i kemi edhe 3 kandidatë që kanë votuar me dorë.

Fjalën e kërkon Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, kolegë të nderuar, vetëm brenda disa ditësh në Kosovë kanë ndodhur shpërthime shumë të rrezikshme në Gjilan, Ferizaj, Klinë duke krijuar frikë, terror dhe rrezikim të jetës së njerëzve. Unë mendoj se Kuvendi i Kosovës sot duhet të japë një deklaratë. Në të cilën do të thuhej që i dënon me forcë këto akte që mund të cilësohen si akte frike, terrori dhe krimi, që rrezikojnë jetën e njerëzve, që krijojnë pasiguri te qytetarët dhe që mund të konsiderohen sulme ndaj qytetarëve, ndaj individëve dhe ndaj institucioneve, që Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga SHPK-ja, policia e UNMIK-ut dhe nga të gjithë ata që kanë përgjegjësi për sigurinë në Kosovë, që aktorët e këtyre veprimeve të sillen para ligji dhe në të njëjtën kohë t'i parandalojnë veprimet që rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe në fund Kuvendi i Kosovës të tërheqë vërejtjen dhe të vlerësojë që veprimet e tilla rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe në të njëjtën kohë krijojnë atë që quhet pamje jo e mirë e Kosovës në kohën kur duhet të zgjidhet statusi i saj përfundimtar. Pra, kërkoj nga ju që me forcë të dënohen veprimet e tilla dhe të parandalohen nga përgjegjësit. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI - Përshëndetje z. kryetar, z. kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë.

Dua Fillimisht dua t'ju njoftoj se ata që nuk janë të njoftuar për një incident që ka ndodhur në hyrje të Kuvendit një javë më parë, me ç'rast policët që mbajnë rend aty, kanë sulmuar gazetarin Enis Veliu, i cili po vinte të më intervistonte. Unë dua të shpreh indinjatën time të thellë me këtë rast dhe them që më së paku është vendi që në Kuvend ose rreth Kuvendit të ndodhin ngjarje të tilla që nuk i përkasin uniformës së policit dhe kërkoj që këto raste të mos përsëriten. Është e çuditshme që polici ende punon në qetësi pa u trazuar. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Problemi që e ngritni është mjaft shqetësues, por unë, me sa kam njohuri, është ngritur procedura ndaj atij polici.

Vë në votim propozimin e z. Sabri Hamitit, fjalën e kërkon Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Faleminderit z. kryetar. Mendoj që për pikat e rendit të ditës secili deputet ka të drejtë të flasë, që edhe kryetari të mos bëjë lutje që të hiqet dorë nga fjala, sepse secili që e kërkon fjalën e di pse e kërkon. Është hera e dytë që sot e kërkoj fjalën dhe nuk e marr. Si do që të jetë dua të dal në temë.

Ne si grup parlamentar herën e kaluar e kemi ngritur një çështje të ngjashme lidhur me sigurinë në Kuvendin e Kosovës. Kemi shprehur brengosje të thellë sidomos për shpërthimet e fundit në një ose mënyrë tjetër ndaj ministrit të Brendshëm dhe ndaj të tjerëve. Mendojmë se çështja e ngritur nga z. Hamiti se duhet të ngritet dhe të diskutohet në Kuvendin e Kosovës dhe nuk duhet të jetë çështje e një deklaratë politike. Kjo deklaratë

përkrahet dosido nga Grupi Parlamentar i PDK-së, por duhet të jetë temë e diskutimit, ku duhet të raportojnë njerëzit përgjegjës për siguri në Kosovë, në njërën nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Unë e mbështes propozimin e z. Hamiti që të merremi me këtë çështje, por mendoj se këto probleme kanë procedurë e cila duhet të ndiqet dhe jam plotësisht dakord me propozimin e z. Kuçi që çështja e sigurisë meriton debat serioz, duke përfshirë këtu edhe kompetencat e institucioneve të Kosovës, në këtë rast të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Unë kam dëgjuar deklarata shumë të papërgjegjshme, ndonjëherë edhe nga vetë ministri edhe për prokurorin e Kosovës i cili është shprehur publikisht që Prokuroria nuk mund të marrë në shqyrtim vepra të rënda për shkak të pasigurisë, por tani po bëj pyetje kush duhet t'ia bëjë sigurinë Prokurorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe shumë pyetje të tjera, me të cilat ne duhet të merremi duke përfshirë këtu edhe kompetencat, se a ka kompetenca kjo ministri, a ka kompetenca policia e Kosovës që të merret me këtë çështje apo thjesht po luajmë me njëri-tjetrin, po luajmë me këtë institucion dhe po bëhemi se kemi diçka në dorë dhe kur të vijë puna bëjmë me gisht nga komisionari i përgjithshëm ose bëjmë me gisht nga policia e UNMIK-ut, tani unë mendoj se Parlamenti dhe grupet parlamentare në përgjithësi janë deklaruar kundër këtyre incidenteve që kanë ndodhur, kundër këtyre sulmeve pa marrë parasysh prapavijë e tyre sepse askush nuk e di deri tash edhe pse dikush ndoshta përpiket me i përfitue edhe viktimat edhe çastet për përfitime personale, politike ose grupore. Mendoj se kjo çështje meriton vëmendje të duhur dhe ka nevojë të përgatitemi. Në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme në veçanti duhet të përgatitë një dosje. Me këtë rast nuk e kam fjalën për dosje të detajuar, e cila dëmton hetuesinë, por fenomenet si fenomene për çështjet me të cilat opinioni dhe deputetët duhet të informohen dhe t'i trajtojmë. Mendoj se për propozimin e z. Hamiti do të duhej tani të votonim a të futet në rend dite apo jo dhe ku është deklarata, sepse nëse duhet të bëjmë deklaratë, ne duhet ta kemi deklaratën që ta votojmë atë dhe jo propozimin. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në mbledhjen e tij të rregullt i ka diskutuar këto çështje. Deputeti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, e ka shprehur qëndrimin e LDK-së lidhur me deklaratën, që do të thotë se ju lusim që atë ta vëni në votim. Dhe nën dy, grupi ynë mendon se për çështje të sigurisë tash pasi e kemi komisionin për siguri, i cili e ka rolin parlamentar të mbikëqyrjes së organeve të Sigurisë që Komisioni ta përgatitë për Kuvend një raport dhe pas atij raporti Kuvendi do të debatohet. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - I nderuari z. kryetar, z. kryeministër dhe i gjithë kabinetet qeveritar. Unë mendoj, meqë Grupi Parlamentar i LDK-së kërkesën e të cilit e artikuloi, profesor Sabri Hamiti, ka të bëjë me deklaratën dhe propozim im është të

mbledhen shefat e grupeve parlamentare dhe ta hartojnë deklaratën në mënyrë që sot deklarata të dalë nga Kuvendi së bashku me propozuesin, kurse për çështje të cilat u ngritën që të debatohen në Parlament, të debatohen ashtu si u thanë, por më vonë.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e kërkon z. Hysa.

DEPUTETI YLBER HYSA – E konsideroj se duhet të deklarohe mi rreth kësaj çështje që e ngriti deputeti Hamiti, ne opinionit i kemi dalë borxhi me qëndrimin tonë, i cili tashmë është publik, me të cilin e dënojmë këtë akt, jo vetëm këtë, por të gjitha aktet që kanë ndodhur ditëve të fundit dhe ne i kemi cilësuar këto si shpërthime kundër pavarësisë. Në këtë aspekt dua të them që kjo nuk mund të jetë punë e Komisionit të Sigurisë, sepse nuk është çështje e mbikëqyrjes së organeve, pasi në këtë rast dhuna është bërë ndaj organeve të cilat bëjnë sigurinë. Pra, vetvetiu është i një dimensionit politik dhe duke marrë parasysh edhe rrethanat të cilat i përmendi sot edhe kryetari i Parlamentit, bëhet fjalë për mbledhjen e Këshillit të Sigurimit, fazën e fundit të procesit negociator dhe faktin që kjo dhunë është përdorur edhe në konstelacione politike, vetvetiu, e ka një dimension më kompleks dhe politik dhe si i tillë ne do ta kishim përkrahur që të shtrohet edhe në Kuvend, të respektohet procedura me shpresë që ajo të jetë më e shpejtë.

KRYTARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit z. kryetar, kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Unë mendoj se kryetari i Kuvendit duhet t'i përmbahet agjendës dhe rendit të ditës. Ne u morën vesh sot para kësaj seance që grupet parlamentare t'u përmbaheshin rendit të ditës. Deklaratat, qoftë të grupeve, qoftë ato individuale mund të hyjnë në rend të ditës pas shqyrtimit me Kryesinë e Kuvendit dhe në grupet parlamentare, por Grupi Parlamentar për Integrim pa dyshim se i dënon të gjitha aktet e dhunës që kanë ndodhur, që janë akte kundër procesit të Kosovës dhe të gjithë deputetët do t'i dënojmë. Por është shumë më rëndësi që para se të bëjmë një deklaratë shumë më përmbajtësore dhe më substanciale që t'i kemi para Kuvendit në foltore edhe Komisionerin Vitrup edhe z. Sheremet Ahmetaj edhe ministrin e Brendshëm që të japin informacione më të hollësishme për procedurat e hetimeve se kush është pas këtyre akteve terroriste, këtyre akteve të shëmtuara e pastaj deputetët mund të dalin me një deklaratë pak më të plotë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në pajtim me rregullën 29, propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për miratimin e një deklaratë e vë në votim.

Lus deputetët që të deklarohe n.

Kush është për.

Votojmë tash:

Për61,

Kundër..... 4.

Miratohet propozimi i deputetit Sabri Hamiti.

Fjalën e ka Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar e shpreh protestën time se edhe në seancën e kaluar e kam kërkuar fjalën dhe nuk ma keni dhënë, po ashtu edhe në këtë seancë nuk deshët me ma dhanë. Unë desha ta tërheq vërejtjen për ata që po propozojnë deklarata, për ata që po merren me pasoja, pa i goditur shkaqet asnjëherë. Të mos lejojmë që ky Kuvend ,ashtu siç ka ndodhur qe 7 vjet vetëm me distancime dhe me dënime, të bëhet pjesë e kësaj zhurme politike dhe ky Kuvend të mos bëhemi dordolec politik sa herë të na thonë me dalë e me u distancu, por të merremi me shkaqet. Kuvendi duhet të mbaj qëndrim dhe duhet të gjej zgjidhje, t'u jep rrugë problemeve themelore, shkaqeve që e kanë krijuar këtë gjendje në Kosovë dhe vazhdojnë ta kultivojnë edhe mëtej. Shkaku është se statusi i Kosovës qe 7 vjet dhe agresioni i vazhdueshëm i Serbisë dhe ndërhyrjet e sajë të vazhdueshme në Kosovë, prandaj ky Kuvend për këto çështje duhet të mbajë qëndrim, duhet të angazhohet të finalizohet vullneti i popullit të Kosovës, t'i kthehet këtij sovranitetin i uzurpuar edhe atëherë politikanët dhe institucionet e Kosovës duhet të mbajnë përgjegjësi. Sot politikanët nuk i kanë kompetencat as për siguri, vetëm po luajnë rolin e dordolecëve për me dalë e me u distancu sa herë t'u thotë dikush me dalë para televizionit. Ju lutem t'i jepet fund kësaj loje, të merremi me shkaqet, kurse ky Kuvend ta bëjë një deklaratë me të cilën do ta denonte agresionin jo vetëm kushtetues të Serbisë, por edhe ndërhyrjet e saj të përditshme në Kosovë. Krejt bota këtë e di se këto janë pasoja të politikave agresive serbe, pasojë e mediave serbe që i përkrahin këto politika, pasojë e shërbimeve shumë të organizuara në Kosovë që e dini ju dhe e gjithë bota ,pra të mos bëjmë lojë ta mashtrojmë njëri -tjetrin dhe opinionin, t'i japim fund kësaj gjendjeje duke finalizuar vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, vetëm atëherë ju institucionet e Kosovës dhe populli i saj t'i marrin përgjegjësitë e veta. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, i patëm dy propozime dhe mendoj se edhe propozimi i anëtarit të Kryesisë z. Xhavit Halitit të qitet në rend të ditës dhe konsiderojmë se brenda një jave ky Parlament duhet mbi bazën e raportit që e jep ministri i punëve të Brendshme të zhvillojë debat për sigurinë dhe të gjitha rrjedhojat që kanë të bëjnë me sigurinë në Kosovë.

KRYETARI – Unë mendoj se nëse veprojmë ashtu do të duhet ta zgjatnim pak afatin për një javë më tepër. Është e pamunshme që brenda një jave të përgatitet diçka e tillë. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

Faleminderit z. kryetar. Lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së ne e përkrahim, sepse të gjithë jemi të interesuar që të jemi të sigurtë, me gjith atë mendoj se duhet të shtrohet kërkesa sipas procedurave të caktuara me Rregulloren e punës, prandaj në vazhdim, me qenë se ne e vumë si pikë të rendit të ditës votimin e amendamentit, propozoj të kalojmë në atë pikë të rendit të ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI - Z. kryetar unë do t'i ngrit dy çështje momentalisht. E para ka të bëjë me shkeljen e procedurave që i bëni të Rregullores së punës së Kuvendit ndaj të drejtave të deputetit, me rastin tim konkret, për pikën e parë të rendit të ditës që nuk ma keni dhënë fjalën dhe po ashtu me rastin kur kërkoja replikë, do të thotë se keni bërë

dy shkelje pa filluar ende mirë mbledhja e Kuvendit. Çështja e dytë, që dua të them, nuk ishte qëllim ynë që ta kundërshtojmë deklaratën, por qëllimi ynë ishte që të shkojmë më tutje, sa për informim tuajin deklarata është si dukuri më shumë e sistemeve joinstitucionale dhe paralele, ndërsa institucionet më pak bëjnë deklarata dhe më shumë raporte për punë konkrete. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Unë e kam shtruar një kërkesë si deputet dhe e kam bërë një propozim të njëjtë, siç e ka bërë kolegu im z. Sabri Hamiti. Në qoftë se propozimi i z. Sabri Hamiti duhet të vihet në votim, dua që edhe propozimi im të vihet në votim. Nuk është pyetje se a do të jetë të enjten apo të premten, dua që ky parlament të marrë vendim që në seancën e ardhshme ministri i Brendshëm i Kosovës të vijë në interpelancë në Kuvendin e Kosovës për çështjen e sigurisë në Kosovë dhe duhet të vihet në votim propozimi. Në qoftë se këtu propozimi i një deputeti patjetër duhet të miratohet dhe i një deputeti duhet të injorohet, atëherë nuk di se a kemi me një parlament, i cili vërtet dikush ka ndonjë kompetencë dhe fuqi më të madhe apo si është puna?

KRYETARI – Propozimi i deputetit Sabri Hamiti pat mbështetje edhe prej grupeve të tjera, prandaj mund ta hedhim në votim edhe këtë.

Kush është për propozimin e deputetit Xhavit Haliti të mbështetur nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe i AAK-së?

Fjalën e ka z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Së pari një vërejtje për ata që i ke përreth që gjithmonë i mbajnë sytë nga ne dhe nuk të informojnë se dikush e ka kërkuar fjalën, sa për të dalë në fotografi, ka vende ku dilet dhe jo aty dhe së dyti po vërej një jokonsekuencë të këtij Kuvendi për çështje të njëjta, kur shtrohen kërkesat nga grupi parlamentar, siç ishte edhe në seancën e kaluar, që të bëhet një komision, ta quaj kushtimisht hetimor për të vërtetuar atë që ka ndodhur në objektet e policisë dhe sjelljet e policisë nga grupe të ndryshme parlamentare. U tha se dihet procedura dhe duhet të vazhdojë. Sot u kërkua e njëjta çështje që në kuadër të asaj që po e quajmë pasiguri, përveç asaj deklarate të thirret një seancë, ku do të diskutohet për çështjen e sigurisë. Prapë i njëjti avaz, dihen procedurat dhe në qoftë se dihen procedurat edhe në rastin e parë edhe në të dytin, është dashur të shkohet sipas procedurave dhe lus ata që thirren në procedura vërtet t'i respektojnë.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - Z. kryetar, ne kemi të bëjmë me dy propozime krejtësisht të kundërta nga këndvështrimi i Rregullores së punës së Kuvendit. Z. Sabri Hamiti ka propozuar të nxirret deklarata, kurse z. Xhavit Haliti, kërkon interpelancë. Çështja e interpelancës është rregulluar me nenin 25 të Rregullores, prandaj është rregullorja si bëhet interpelanca. Ajo bëhet me shkrim, mund të paraqesin jo më pak se 10 deputetë edhe kërkesa në formë të shkruar.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Në qoftë se çështja e sigurisë është për të bërë deklaratë, s'ka problem as për mua, po bëjmë deklaratë dhe mbaroi çështja e sigurisë. Por unë kam konstatuar si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe si anëtar i Kryesisë që procedura është shkelur, është votuar diçka për t'u futur në rendin e ditës pasi që është votuar rendi i ditës. Meqenëse ka ndodhur kështu, askush nuk ka të drejtë të thirret në dofarë rregulloresh, cilatdo qofshin ato që ua kufizojnë të drejtën deputetëve të votojnë mbi bazën e një propozimi. Unë nuk konsideroj se është shkelje e rregullores në qoftë se ne votojmë për debat në seancë lidhur me çështjen e sigurisë dhe në një seancë ministri i Brendshëm do të raportojë për çështjen e sigurisë në Kosovë, të paktën ka çka të raportojë, sepse edhe vetura e tij është shkatërruar dhe sulmi është bërë edhe kundër tij.

KRYETARI– Fjalën e ka Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Unë kisha propozuar z. kryetar të bëhet një pauzë, dua të them se puna e Rregullores sot është bërë punë elasticiteti që po e përdorim si po duam ne edhe me rastin e deklaratës politike rregullorja është shkelur edhe në rastin e vënies në votim, përsëri janë shkelur edhe rregullorja edhe Korniza Kushtetuese e Kosovës. Në rastin e vënies në votim të mendimit të panelit, në rastin konkret kur flitet për çështje, që interpelanca është diçka tjetër që e tha znj. Nekibe,, në emër të Grupit Parlamentar mund ta hedhë në diskutim si çështje urgjente kushto nga ne dhe ajo duhet të vihet në votim. Mendoj se duhet ta lexoni mirë Rregulloren, sekretari t'ju ndihmojë dhe rregullorja të interpretohet në mënyrë të barabartë dhe jo në mënyrë të njëanshme. Nëse ka nevojë ligjërata për rregulloren ose tendenca për rregulloren, ka vend dikund tjetër, ndërsa këtu duhet ta zbatojmë, të votojmë dhe të jemi konkretë.

KRYETARI– Ju faleminderit z. Kuçi, fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani .

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar. Së pari mbështes propozimin e z. Xhavit Halitit, por me qenë se propozimi i z. Sabri Hamitit është votuar, unë propozoj të tubohen shefat e grupeve parlamentare, ta përgatisin deklaratën dhe ta njoftojnë Kuvendin e pastaj të vazhdohet me punë, Ju faleminderit.

KRYETARI– Fjalën e ka Numan Baliq.

POSLANIK NUMAN BALIĆ – Ja ću vrlo kratko da kažem nekoliko rječi. Mislim da nema potrebe da se nadmudrujeo oko neke stvari očigledno je da procedura sada već u drugome redu nakon što smo već vidjeli da je prosto je nametnuto pitanje zakona o jezicima i da smo jednostavno prinuđeni da glasamo nakon opomena koje smo dobili kao povlačenja za uši od Međunarodne Zajednice što je sa svim očigledno, imamo na djelu jedan predlog koji je sasvim opravdan g. Haliti je tražio da se raspravlja o pitanju sigurnosti, mislim da nema potrebe da ovde ponovo uzgajamo neko rivalstvo, koj je bolji, koj je jači i ko je pametniji, tema sigurnosti svima nama interesuje, nema nikakvog razloga da se ne razgovara, predlažem da se završimo sa ovom diskusijom, da se prihvati predlog g. Halitija i da se na nekoj narednoj sednici što je moguće prije organizuje i rasprava o sigurnosti i pitanja napada na ministra i građana na stanovnike u Klini itd, i da svakako da bude prisutan i novi komesar za policiju pa da vidimo i njega kako će on djelovati jer ovaj dosadašnji nije baš proslavio, Hvala!

KRYETARI – Ju faleminderit, pasi për propozimin e z. Haliti janë deklaruar 3 grupe parlamentare më duhet ta vë në votim.

Po votojmë sot për një të tjetër nga seancat e ardhshme.

Propozimi i z. Haliti, i përkrahur edhe nga grupet e tjera që të vihet në rend dite në një të tjetër nga seancat e radhës, e vë në votim.

Votojmë tash:

Për.....72

Kundër 12

Miratohet propozimi.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

2. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës z. Agim Çeku sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së.

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit Grupi Parlamentar i PDK-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Qeverisë së Kosovës z. Agim Çeku.

Në afatin e paraparë me Rregullore të punës kryeministri i është përgjigjur ftesës për interpelancë.

Kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe përgjigjja e kryeministrit u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 25.2 të Rregullores së punës debati për interpelancë mund të zgjatë deri në dy orë. Sipas rregullës 25.7 Grupi Parlamentar, i cili ka kërkuar interpelancën mban të drejtën e zgjerimit të debatit në kohëzgjatje 10 minutash dhe në përmblyllje të debatit deri në 5 minuta.

Fjalën e ka paraqitësi i interpelancës Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë

Fillimisht më duhet të them se kërkesa për interpelancë është bërë para një muaji .Në një masë kjo interpelancë e ka humbur autoritetin e saj dhe kjo nuk është hera e parë që veprohet kështu. Kjo është lojë, si me legjislativin, po ashtu edhe me opinionin qytetar që pret nga ju ta qeverisni vendin duke hapur perspektiva zhvillimore, mbrojtjen e ligjit e siguri për qytetarët pa dallim. Grupi ynë parlamentar edhe pse jemi në opozitë, jemi shumë të interesuar që Kosova në këto momente të ketë dhe të udhëhiqet nga një kryeministër që e ushtron autoritetin e tij mbi tërë kabinetin qeveritar .Pra, ky do të ishte interesi i qytetarëve të Kosovës, natyrisht edhe yni. Ne konsiderojmë se letra e Kryesisë së LDK-së është atak në institucionin më të lartë të Kosovës, mbi ekzekutivin, e relativizon autoritetin e kryeministrit, fuqinë e tij vendimarrëse e politike, autoritetin e tij në raport me faktorin ndërkombëtar, krijon institucion jofunksional e shumësi kryeministrash, shkapërderdh përgjegjësitë, humb kontrollin në mbikëqyrje, në administrim të mjeteve financiare dhe në menaxhimin e resurseve njerëzore, në kontrollin dhe në administrimin e lartë të shtetit, në mbrojtjen e ligjeve të standardeve etj. Lidhja Demokratike,që ju ka dërguar me 6.7.2006 në pikën 1 ka kërkuar që të gjithë ministrat, zëvendësministrat, zyrtarët e lartë të agjencioneve, të bordeve e të departamenteve në të ardhmen të jenë nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

A i keni konsultuar; Rregulloren 2001/19, Rregulloren për shërbyesit civilë 2001/36, Urdhëresën administrative dhe implementimin e saj dhe 12 procedurat e shërbimit civilë. Çka keni bërë që ta pengoni politizimin e shërbimit civil, ta mbroni nga diferencimi, ta pengoni joprofesionalizmin dhe t'i mbroni ata që padrejtësisht janë larguar nga puna dhe për të cilët keni vendime që duhet t'i ktheni në punë, bile keni edhe sugjerime nga shefi i UNMIK-ut, nga ish- shefi i UNMIK-ut, nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe nga mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë se KELB-i që e drejtoni ju është ndërruar nga organi për emërimet të larta, në organ për përjashtime të qytetarëve të lartë. Keni edhe raporte zyrtare që konfirmojnë këtë që po e themi ne. A i keni parë ato raport? Çfarë reformimi të administratës publike mund të bëjë një kabinet i tillë qeveritar. Administratën publike duhet ta udhëhiqni ju z. kryeministër. A po e bëni ju këtë, a e keni mbrojtur ndonjë zyrtar të lartë nga abuzimet e ministrave të kabinetit tuaj, t'i mbroni zyrtarët që ishin shumë më profesionalë, kanë punuar ndershmërisht e me përgjegjësi që tërë jetën e tyre kanë qenë të angazhuar dhe kanë kontribuar për të ardhur këtu ku jemi ne edhe ju. Njerëzit që i mungojnë kabinetit tuaj qeveritar si për ngritjen politike, intelektuale, profesionale si për ndershmëri dhe përkushtim atdhetar, kualitetet e tilla i mungojnë kabinetit tuaj z. kryeministër.

Në pikën 2 të letrës nga LDK-ja Lutfi Haziri emërohet ministër i dytë i kabinetit qeveritar, si po funksionon ky dualizëm, a ka ndonjë qeveri tjetër në botë që funksionon me dy kryeministra, apo ju jeni shembull unikat në botë. Z. kryeministër, sa ka ndikuar kjo letër në ushtrimin e funksionit tuaj si kryeministër, ju keni deklaruar se pas një muaji do të verifikoni punën e secilit anëtar të kabinetit qeveritar, cilat masa i keni marrë për t'i larguar të paaftët, të korruptuarit, shkelësit e ligjeve, të inkriminuarit dhe keqpërdoruesit e buxhetit të konsoliduar të Kosovës? Edhe gjatë mandatit tuaj ka vazhduar qeverisja e nisur nga paraardhësit, keqmenaxhimi, shfrytëzimet e pa planifikuara të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, çfarë keni bërë për t'i penguar këto dukuri të dëmshme të dënueshme me ligje në fuqi? A i keni shikuar raportet e auditorit gjeneral, a e keni stafin e mjaftueshëm profesional për t'ju ndihmuar në ushtrimin e përgjegjësive tuaja, a e keni marrë ndonjë masë për t'i penguar keqpërdorimet që u bëhen parave të tatimpaguesve kosovarë?

Z. kryeministër, a mos jeni edhe ju kryeministër sikur zotështëpia i familje pa zotëshpie, kur mysafiri e pyet fëmijën se kush është zot shtëpie në këtë shtëpi, fëmija përgjigjet: "të gjithë ngapak vetëm baci fare". A po ndodh kjo edhe me Qeverinë që drejtoni ju se të gjithë janë më shumë kryeministra vetëm ju që nuk jeni fare kryeministër. Ne do të dëshironim që ta argumentoni të kundërtën me fakte që t'i bindni së paku qytetarët se ju e qeverisni Kosovën.

Sa mund t'i zbatojë standardet një qeveri që i shkel ligjet në fuqi, një qeveri thujse asnjë nga zyrtarët e lartë nuk i kanë kaluar procedurat e institucionit të konkursit, janë ushtrues të detyrave, një qeveri që Këshillin për Emërimet të Larta e ka kthyer në vegël të një klani politik tepër të dyshimtë e të inkriminuar, ai është këshill privat i kryeministrit, jo këshill i pavarur mbikëqyrës.

Ju z. kryeministër pas kësaj letrë që ju zhvesh nga e drejta për të qeverisur vendin është dashur ta rishikoni seriozisht pozicionin tuaj si kryeministër, mos lejoni rrënimin e autoritetit tuaj moral që ju ka dhënë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, se po e bëni edhe një tjetër mëkat ndaj një vlere të shenjtë të kombit. Është mirë të nxirrni mësim nga anekdota. Kjo do të ishte për të mirën tuaj z. kryeministër. Ju faleminderit.

KRYETARI – Fjalën e ka kryeministri i Kosovës z. Agim Çeku.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU - I nderuari z. kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, ministra.

Pa asnjë hezitim ju kam përgjigjur pozitivisht kërkesës për interpelancë dhe do të përpiqem ta sqaroj pozicionin tim ndaj letrës në fjalë. Unë përgjigjen pozitive e kam dhënë po të njëjtën ditë kur e kam marrë edhe kërkesën zyrtare, kështu që nuk kam bërë asnjë përpjekje për ta zvarritur mbajtjen e kësaj interpelance. Fillimisht më lejoni të flas për dimensionin ligjor të emërimit tim dhe të përgjegjësive që kam. Dua të theksoj se unë jam kryeministër legjitim i Kosovës, i nominuar nga presidenti i votuar dhe i aprovuar nga ky Kuvend dhe kompetencat e mia janë ato të cilat burojnë vetëm nga Korniza Kushtuese e Kosovës dhe nga Rregullorja e punës së Qeverisë së Kosovës që unë vazhdimisht i referohem gjatë punës sime dhe asnjë letër tjetër pa fuqi ligjore nuk mund t'i ndryshojë apo t'i kufizojë kompetencat e mia. Dua t'ju siguroj se deri më tani gjatë punës sime kam pasur dhe kam mbështetjen e plotë të partnerëve të koalicionit dhe të arriturat e deritashme të pranuar edhe nga bashkësia ndërkombëtare, janë rezultat i punës sonë të përbashkët dhe i mbështetjes..... Unë vazhdoj të besoj se letra e LDK-së ka qenë më shumë e disenjuar, si çështje që rregullon dhe qartëson raportet në mes dy partive në koalicionin qeveritar dhe është më shumë një informatë për mua në lidhje me marrëveshjen e partnerëve të koalicionit të bërë para se unë të vij në këtë detyrë, pavarësisht nga aludimet e mundshme. si dhe efekti medial që e ka arritur kjo letër, sot me përgjegjësi të plotë konstatoj se letra nuk e ka limituar aspak fushëveprimin tim dhe në asnjë mënyrë dhe për asnjë çast nuk e ka vënë në pikëpyetje mandatin tim si kryeministër. Do t'i jap disa komente rreth asaj çka thuhet në letër. Roli paraprak që e ka marrë z. zëvendëskryeministri Lutfi Haziri nga partia e tij për asnjë çast nuk e ka penguar funksionalitetin e Qeverisë së Kosovës dhe as nuk e shoh si tendencë për krijimin e një fraksioni brenda Qeverisë, por si synim për harmonizimin e brendshëm të veprimeve brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës. Unë bashkëpunoj ngushtë me z. Haziri dhe me kolegët e tjerë nga kolegët e koalicionit dhe jemi të përkushtuar në kryerjen e detyrave ditore të Qeverisë së Kosovës, gjithmonë të vetëdijshëm se uniteti brenda Qeverisë nuk ka alternativë. Sa i përket çështjes që ka të bëjë me pozicione të larta dhe me Qeverinë, kjo është një çështje që ka të bëjë ekskluzivisht me marrëveshjen në mes të partive të koalicionit Qeveritar. Liderët e partive në koalicion janë dakorduar për ndarjen e posteve me qeverinë që unë e udhëheq, një gjë e tillë është normale dhe ndodh në të gjitha vendet demokratike me sisteme zgjedhore të përziera. Zakonisht shërbyesit civilë nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, shërbyesit civilë u nënshtrohet ligjit dhe rregulloreve dhe emërohen përmes KELK-ut, si tha edhe z. Krasniqi. Ndërsa sa i përket rolit udhëheqës të LDK-së në koordinim me AAK-në, siç është thënë në letër, në procesin e statusit të Kosovës, mund të them: Kosova në këtë moment është duke kaluar nëpër një proces shumë të rëndësishëm. Jemi të gjithë të vetëdijshëm për këtë, sepse procesi negociator drejtohet nga presidenti dhe ky grup është mandatar nga ky Kuvend. Për punën tonë kemi debatuar edhe në seancat e kaluara dhe deri më tani kemi dëshmuar se kemi një unitet, harmoni dhe konsensus të plotë brenda grupit. Unë dëshiroj të përshëndes rolin konstruktiv të gjithë faktorit politik që merrë pjesë në këtë grup, duke përfshirë edhe partitë e opozitës gjatë këtij procesi të përbashkët, ruajtjen e unitetit politik dhe të stabilitetit institucional përderisa të zgjidhet statusi politik i Kosovës është jetike për ne”.

Të nderuar deputetë, ju ftoj të mos humbim energji të panevojshme në lidhje me letrën dhe me gjëra të ngjashme që janë faktikisht çështje të brendshme në mes koalicionit qeverisës. Besoj që pajtohemi që të gjithë se gjithë potenciali ynë në këtë fazë duhet të përqëndrohet në çështje më madhore, si statusi final i Kosovës, zhvillimi ekonomik, integrimi i

minoriteteve, implementimi i standardeve, siguria, rritja e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës e shumë tema të tjera jetike.

Dua t'ju siguroj edhe një herë që të gjitha aktivitetet e mia si kryeministër i Kosovës kanë qenë, janë dhe do të jenë në përputhje me mandatin që ma kanë dhënë Parlamenti i Kosovës dhe Korniza Kushtetuese dhe rregulloret në fuqi. Ne jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë argumentin se ka hapësirë për përmirësim të funksionalitetit të Qeverisë sonë, andaj çdo këshillë në drejtim të Qeverisë që unë e udhëheq dhe që ka për qëllim rritjen e efikasitetit është më se e mirëseardhur e sidomos ato rekomandime që vijnë nga ky Kuvend. Unë gjithmonë i përshëndes rekomandimet dhe kritikën që kanë për qëllim reformat pozitive që direkt apo indirekt kontribuojnë në qeverisje më të mirë dhe në rritjen e standardit jetësor të qytetarëve të Kosovës.

Dua të theksoj se unë jam kompetent dhe i thirrur për të mbikëqyrur, kërkuar llogari dhe vlerësuar punën e çdo anëtari të kabinetit qeveritar, asnjë qëndrim apo veprim i zyrës së kryeministrit apo Qeverisë në tërësi i ndërmarrë gjatë muajve të fundit nuk ka dëshmuar të kundërtën. Gjithashtu dua t'ju njoftoj se kam një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe të frytshëm me presidentin e Kosovës, kryetarin e Kuvendit, me liderët e partive në koalicion e sidomos kemi një bashkëpunim të mirëfilltë brenda kabinetit qeveritar. Unë mbetem i përkushtuar për t'u shërbyer vetëm interesave të qytetarëve të Kosovës dhe për të bërë qeverisjen sa më funksionale, këtë dhe vetëm këtë e konsideroj detyrë time. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet punën e Qeverisë dhe në emër të unitetit në veprim, fton opozitën dhe të gjithë deputetët që t'i bashkëngjiten kësaj mbështetjeje deri në zgjedhjet e ardhshme. Grupi Parlamentar i LDK-së me këtë rast e mbështet përgjigjen e kryeministrit të Kosovës lidhur me kërkesën për sqarime nga ana e opozitës. Letrën në fjalë Grupi Parlamentar i LDK-së, e kupton ashtu siç është, komunikim në mes partnerëve të koalicionit dhe është informim i brendshëm dhe ne si grup parlamentar edhe një herë e riafirmojmë mbështetjen tonë për Qeverinë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI - Faleminderit z. kryetar. I nderuari kryeministër. Pas kësaj që dëgjuam sot nga ju mendoj që këtë sikur ta kishit thënë në ditën kur e keni marrë letrën, ju premtoj se edhe PDK-ja nuk do të kërkonte interpelancë nga ju. Unë jam i inkurajuar me përgjigjen që e keni dhënë sot. Mendoj se ka qenë një përgjigje edhe profesionale edhe legale, por njëkohësisht keni treguar edhe fuqi institucionale. Me siguri ju kujtohet që ditën që kemi ngritur këtë çështje kam kërkuar nga ju të tregonit fuqi politike apo të jepni dorëheqje dhe unë jam i gëzuar që sot po tregoni fuqi politike përballë koalicionit, përballë Qeverisë dhe partisë që jua ka dërguar letrën. Nëse letra sipas jush edhe unë e ndaj mendimin me ju, nuk ka fuqi ligjore, nuk ndikon në raportet brenda Qeverisë dhe është më shumë që shpreh raportet brenda LDK-së dhe koalicionit qeverisës. Unë do ta përkrah punën tuaj, fuqinë tuaj politike dhe mund të them që përgjigja në interpelancë është përgjigja të cilën kemi dashur ta dëgjojmë edhe sot, por edhe më herët. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. kryetar, z. kryeministër, ministra, deputetë të nderuar.

Lidhur me temën e interpelancës së sotme shpreh qëndrimin e AAK-së të kryetarit të saj z. Ramush Haradinaj dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e vlerëson korrekte dhe të dobishme çasjen e partnerit të koalicionit qeverisës të LDK-së. Në këtë frymë letrën e drejtuar kryeministrit e sheh si kontribut të më tejme, si rritje të përkrahjes ndaj kryeministrit dhe ministrave të Qeverisë. Si e tillë ajo shpreh interesimin për funksionimin më të suksesshëm të Qeverisë. Japim mbështetje parimeve, çështjeve dhe angazhimeve të shprehura në letër, duke u dhënë mbështetje të plotë kreut të Qeverisë, kryeministrit Çeku, zëvendëskryeministrit- Lutfi Haziri dhe ministrave të Qeverisë së Kosovës. Aleanca do të vazhdojë të përcjellë me interesim të shtuar punën e Qeverisë dhe do ta mbështet atë duke i dhënë sugjerimet e saj. Jemi shumë të kënaqur dhe gjithashtu mbështesim edhe një herë punën e kryeministrit, por edhe të Qeverisë dhe gjithashtu gëzohemi që edhe Partia Demokratike e mbështet punën e Qeverisë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - I nderuari kryetar i Kuvendit, z. Kolë Berisha, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryeministër Agim Çeku.

Letra e Kryesisë së LDK-së e dërguar më 6.07.2006, kryetarit të Kosovës, kryeministrit, zëvendëskryeministrit, kryesive të partnerëve të koalicionit LDK dhe AAK, edhe pse në dukje të parë e paramenduar si letër interne në mes partive të koalicionit, është bërë publike dhe ka shkaktuar reagime të shumta. Në të vërtetë, po të ishte disenjuar prej fillimit si letër interne, do t'u dërgohej vetëm kryesive të partive të koalicionit, e jo institucioneve të cilat duhej të ishin të të gjithëve, e jo vetëm të partive të veta. Në kushte normale kur kemi të bëjmë me shtet, negociatat e ndryshme në nivel shtetëror do të udhëhiqeshin nga qeveritë e atyre shteteve, por të mos e harrojmë faktin se Kosova ende nuk është shtet dhe se këto negociata nuk janë çfarëdo negociatash, por ato të cilat si rezultat do ta kenë formimin e shtetit dhe si të tilla kërkojnë involvimin jo vetëm të pozitës, por edhe të opozitës, në rastin tonë nuk është lehtë që edhe të bëjmë punën e opozitës edhe të jemi së bashku në procesin negociator. Vetëm interesi madhor i finalizimit të aspiratave dhe përpjekjeve të shumë gjeneratave të kosovarëve e arsyeton angazhimin e sinqertë dhe të palodhshëm të opozitës në këtë proces. Prandaj, pika 5 e letres me të cilën tentohet të privatizohet ky proces, nuk mund të merret veprim i mençur dhe qëllimshëm. Gjithashtu pika e parë, e cila flet për nominimin e zyrtarëve të agjencive, të bordeve, të departamenteve, flet për zyrtarizimin e asaj që sot çdokush në Kosovë e di, e ajo është se të gjitha institucionet i kemi politizuar. Dhe me këtë u ndalohet të gjithë të tjerëve hyrja në institucione pa krah.

Kjo letër sapo të merren kompetencat e kryeministrit ndaj ministrave të kabinetit nga radhët e LDK-së, po ashtu edhe "udhëheqja", e procesit negociator nga ana e LDK-së në koordinim të plotë me AAK-në, ka krijuar një imazh jo të vërtetë, një imazh të mungesës së unitetit brenda Grupit Negociator dhe atë si në opinionin publik vendor, ashtu edhe në opinionin ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh kohën në të cilën gjendemi, rrezatimi i unitetit është shumë i nevojshëm për popullin tonë dhe për bashkësinë ndërkombëtare. Mendojmë se kjo letër ka shkaktuar dëm të panevojshëm, që tregon edhe një herë se partnerët e koalicionit proceseve brendapartiake dhe atyre mespartiake, u japin prioritet më pak sesa proceseve me rëndësi kombëtare, prandaj me bërjen publike të kësaj letre kërkuam publikisht prej kryetarit Sejdiu shpjegim të saj. Tani kërkuam edhe nga kryeministri dhe nga autorët e letrës, cilit kryeministër iu ka drejtuar letra -si kryetar i qeverisë, si anëtar i partisë, cilit iu ka drejtuar edhe si anëtar i Grupit Negociator. Kërkojmë t'i shpjegoni përmbajtjen e letrës dhe konsekuencat që i ka shkaktuar ajo në opinionin vendor dhe në atë ndërkombëtar. Dhe përsëri, shpjegimet e kryeministrit se kjo letër nuk ka fuqi ta ndërrojë atë si kryeministër e tjera. Shtrohet pyetja: Pse atëherë pat nevojë për këtë letër? Në qoftë se kjo letër nuk ka fuqi politike, vazhdoni ta kryeni punën sipas përcaktimeve të Parlamentit. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit zonja deputete, fjalën e ka Numan Baliq

DEPUETI NUMAN BALIQ – Ja ću naravno govoriti i u sopstveno ime, ali i ime grupe “za integraciju” u vezi sa ovim pitanjem. Najpre mi dozvolite da kaŕem da ovde nismo zato da bi smo se opredeljivali za i protiv podrŕke aktualnom premijeru Ćekuu, nego zato da realno i istinski damo jedan osvrat na dosadaŕnji delovanje Vlade i njene buduće mogućnosti. Podsetiću vas takođe da smo pre nego ŕto je gospodin Ćeku preuzeo ovu ulogu predsednika Vlade, mi kao grupa za integraciju imali mogućnosti i zadovoljstvo da razgovarimo sa g-dinom Ćekuom i da ponudimo našu spremnost na podrŕku svim procesima na Kosovu, kako pregovaraćkom tako i svima ostalima u gradnji institucija Kosova kao i to da je grupa „za integraciju“ je jedina koja predstavlja ne samo manjinske zajednice nego i ćitav politići spektar na Kosovu, raćunajući kako većinsku zajednicu tako i manjinske zajednice. U tom razgovoru, naravno, ovde smo svedoci toga da moŕemo otvoreno govoriti sam g. Ćeku je rekao da su njegove maneverske mogućnosti veoma male. Da je on, naŕalost u takvoj poziciji, da njegovo delovanje uglavnom zavisi od koalicionog dogovora i uglavnom od odnosa snaga između LDK-a i AAK –a. Nama je najmanje ŕelja da ulazimo u međusobne odnose LDK-a i AAK-a, to je ipak samo njihova stvar i mi to jako poŕtujemo. Mi smo takođe spremni da izrazimo poŕtovanje prema spremnosti g-dina Premijera, predsednika Vlade g. Ćekua , da uvek odgovori na sve pozive koji su njemu upućeni, i to jako cenimo. Dakle, vrlo je dobro da g. Ćeku je spreman da uvek odgovori na sve izazove i na sva pitanja koja mu se postavljaju, ali dopustite da i sebi i javnosti postavimo pitanje: koliko je Vlada stvarno spremna da odgovori na interese naroda Kosova, javnosti Kosova, koja kao ŕto znate je uglavnom ne zadovoljna. Dozvolite mi da vam ponovim rezultate ankete UNDP –a koji je pre nekoliko sedmica, moŕda pre dve sednice izneo podatak prema kome mislim oko 60% građana Kosova nije zadovoljno radom institucija Kosova, radom Vlade Kosova koje su naše zajednićke institucije. Ovo govorim kao ćlan Parlamenta Kosova, kao poslanik u Skupŕtini, kao ćlan grupe za integraciju i kao onaj koji je istinski zabrinut za procese na Kosovu i zainteresovan za ukupni doprinos svih nas. Zar nam se ne deŕava svima nama da nas na ulici pitaju, pa ŕta vi gore u Vladi moŕete da uradite i ŕta vi tamo u Parlamentu radite. To je pitanje koje postavljaju i LDK-u, PDK-u i AAK-u i svima nama . Moramo priznati sebi da ljudi nisu zadovoljni, dakle, da zaključim, apsolutno je besmisleno da se delimo na te koje podrŕavaju premijera i koji su protiv premijera. Ovde je u pitanju ukupno delovanje

institucija Kosova koje nažalost dosad nije bilo zadovoljavajuće . Standardi nažalost nisu ispunjeni, mi možemo proglasiti da su oni svi ispunjeni, ali ubrzo nakon toga dobićemo opomenu i ponovo će nas povući za uši ovi iz međunarodne zajednice kao u slučaju zakona o jeziku. Zar nije parlament Kosova doneo odluku prema kome je odbijen zahtev vezano za turski jezik, pa onda su nas nagazili i naredili nam kao maloj deci, slušajte vi to morate usvojiti. Dakle, nemojmo glumiti pred javnošću da smo mi mnogo jači i sposobniji nego što ustvari jesmo, moramo ozbiljno i realno sagledati mogućnosti koje postoje , a one su sledeće, nažalost Vlada nije sveobuhvatno, nažalost Vlada nije ispunila mnoge stvari koje je obećala, nažalost manevarski prostor g-dina čekua je jako mali i on je limitiran osnosima LDK i AAK i to mora priznati i on i mi svi i pomenute partije. Na kraju krajeva mi možemo Vladu kovati u zvezde, ali zar je moguće da celokupna javnost na Kosovu zna da ima jedan broj ministara koji su potpuno nekompetentni, nesposobni i neodgovarajući, zar nismo pre mesec dana proglasili na nivou Vlade to ta je urgentno stanje ili dramatično stanje u ministarstvu zdravlja, a sada govorimo i dajemo podršku bez razmišljanja, Vlada je odlična, Vlada radi dobro i mi joj dajemo jednodušnu podršku. Dakle, najmanji je problem da mi jednoglasno podržimo Vladu, nego je problem u tome da realno sagledamo mogućnosti i da odgovorimo tim izazovima, na kraju krajeva ako je sve u redu zašto je osnovano međuministarsko veće koje će raditi na tome da se zamene pojedini ministri, ali nije problem u tome , problem je u tome da se ovde nameću zadaci, dakle g-din Haziri će menjati ministra iz redova LDK ili će ih zadržati, a onaj drugi će zadržati one svoje ministre. To je apsolutno jedna stvar koja je nerealna, nelogična i koja sputava premijera Čekua. Naravno, apsolutno da mi neželimo da ulazimo u unutrašnje odnose ovih dveju partija niti da mi određujemo ko će kako delovati , ali činjenica je da najveći broj političkog spektra je zapostavljen ili je oneomogućen da deluje kako opozicijone partije tako i manjinske partije i manjinske zajednice. Već sam rekao da nažalost najveći broj standarda nije ispunjen, već sam rekao to da stvari vezano za procese pregovaranja o Kosovu su jako zaostali i da mi trebamo biti zabrinuti time šta se dešava sa standardima, šta sa decentralizacijom, šta sa pitanjem povratka koje nije ni krenulo. Pitanje povratka, molim vas, nije ni krenulo dakle ima mnogo pitanja koja su aktuelna i kojima moramo naći odgovor. Pre nekoliko dana g-din Dedaj koji je član naše grupe za integraciju i vođa partije LPK ovde na Kosovu je javno pozvao odnosno nagovestio poziv na odgovornost grupe za pregovore i ljudi koji vode institucije Kosova. Mi u grupi za integracije se pridružujemo tom pozivu na odgovornost, dakle mislimo da dosada oži procesi koji se tiču ispunjenja standarda i pregovora o statusu Kosova nisu urodili plodom. I molim vas ne želimo da budemo zlosluti, ali moramo biti jako zabrinuti time dali će stvarno međunarodna zajednica iako se Kosovo nalazi u završnoj fazi pregovora o Kosovu, dali će ona stvarno biti spremna da nemetne jedno jednostrano rešenje nasuprot Prištine i Beograda. Dozvolite da sam procenim da neće nametnuti rešenje i da će se nažalost težiti nekoj vrsti kompromisa gde mi na Kosovu možemo biti jako pogođeni ili jako uskraćeni. Javnosti smo dužni da objasnimo neke stvari prema tome da ponovim mi smo apsolutno spremni da učestvujemo u svim procesima, u procesima izgradnje institucija Kosova, u procesima ispunjavanja standarda, u procesima pregovora o Kosovu, ali ovako kako je dosad rađeno nije u redu i nije dobro. Da dopunim naravno da onu zamerku koju smo imali vezano za grupu za pregovore a koja se ticala da manjinske zajednice su morale biti uključene u pregovarački proces, u glavnu pregovaračku grupu, to je manjkavost koja je sada nenadoknadiva. Vi znate da su neki insistirali na tome i iz opozicionih partija i da smo mi iz manjinskih zajednica i grupe za integraciju to podržavali . Sada konstatujem da nakon što je pregovaranje na ovaj način uglavnom završeno ili u fazi završetka da mi možemo reći da je

to ne uspela stvar. Dakle, sasvim na kraju, naša spremnost da učestvujemo u svim procesima i da damo doprinos postoji, međutim institucije Kosova, predstavnici Vlade, g-din premijer Čeku mora se ozbiljno zabrinuti i razgovarati sa svima, razgovarati kako sa predstavnicima u parlamentu tako i sa onim zajednicama i pozivom koji sam prošli put kada sam govorio da zajednice treba obići na terenu, ja ponavljam poziv treba obići zajednice na terenu i mi vas pozivamo ove rede da obiđete ljude i da s njima razgovarate i da nije dovoljno ovde da se samo govori u parlamentu u Vladi itd. Hvala vam lepo i mislim da je to naš doprinos svemu ovome.

KRYESUESI – Ju faleminderit z. deputetë, fjalën e ka Xhavit Haliti

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryesues i seancës, z. kryeministër, ministra të nderuar. Së pari do të shpreh mirënjohje për gatishmërinë e kryeministrit për të ardhur në seancë. Unë mendoj se gjatë diskutimit të tij na ka mbetur borxh edhe neve partive të tjera, në veçanti drejtuesve të partive që të kemi të drejtë të drejtohem me letra dhe të merren në konsideratë nga Qeveria, meqenëse edhe ne mund t'i drejtohem në emër të partisë-kryeministrit.

Mendoj që raportet për të ndërtuar një koalicion ndërtohen me marrëveshje dhe ato firmosen nga drejtuesit kryesorë dhe ka penallti në qoftë se dikush i shkel ato. Ne ndoshta nuk është çështje e opozitës që ta njohë marrëveshjen, por të paktën nuk kam parë ndonjëherë në një marrëveshje se si duhet të funksionojë dhe si do të funksionojë ky koalicion, të paktën nuk kam informata a janë takuar drejtuesit kryesorë të subjekteve të koalicionit për të modifikuar eventualisht marrëveshjet e mëparshme për të funksionuar Qeveria. Unë e kuptoj që në raport me Qeverinë gjithmonë ka kundërthënie nga legjislativi dhe nga partitë politike dhe ato janë krejtësisht normale, dihen kërkesat në raport me Qeverinë që mund t'i bëjë legjislativi, dihen kërkesat e partive për të kontrolluar politikën e qeverisë dhe për t'i kontrolluar edhe tenderët e Qeverisë.

Një ndër pyetjet që do ta shtroj sot për kryeministrin është: Ku janë ministrat sot? Është nënçmim në raport me drejtuesin e Qeverisë, që shprehi besim të madh në kompetencat e veta për këtë qeveri dhe kryeministri nuk do të mund të vinte në interpelancë, kurse të mos jenë të gjithë ministrat një për një, duke përjashtuar ndonjërin i cili mund të ishte në detyrë zyrtare jashtë Kosovës.

Për mua kjo ka domethënie të veçantë pse ministrat nuk janë këtu. Ne jemi mësuar me thëniet dikur kur emocionoheshim që uniteti parti- popull -qeveri është i lidhur si mishi me kockën, gjë që unë nuk e besoj për sot që është ashtu. Uroj që kryeministri dhe ministrat të jenë të përgjegjshëm në raport me kompetencat që i kanë dhe me ligjin që duhet ta zbatojnë që të mos pranojnë urdhra nga partitë e tyre kur është fjala për shkeljen e ligjit. Betimi, dhe zotimi, ditën e krijimit të kësaj qeverie dhe të gjitha qeverive të tjera është një, për t'u shërbyer popullit dhe vendit dhe për të zbatuar ligjet dhe kushtetutën. Besoj që asnjëri nga ministrant, duke përfshirë edhe kryeministrin nuk guxojnë që në emër të funksionarëve partiakë të shkelin as ligjin as kushtetutën dhe do të dëshiroja shumë që për hir të opinionit dhe të obligimit, ndoshta politik, që ka ky koalicion qeverisë, meqenëse është hapur kjo çështje që të bëhet publike marrëveshja në mes koalicionit vetëqeverisë që ta dimë edhe ne si janë të ndërtuara edhe raportet.

KRYESUSI – Ju faleminderit z. deputet fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuri z. kryeministër në paraqitjen tuaj ju thatë se kjo letër nuk është asgjë tjetër vetëm një rikonfirmim i marrëveshjes së mëpushme në mes koalicionit qeveritar. Në qoftë se është kjo e vërtetë, që unë konsideroj që nuk është, atëherë në këtë letër nënshkrues do të duhej të ishte edhe koalicioni tjetër, në këtë rast AAK-ja dhe subjektet e tjera dhe si të tillë ne do ta kishim parë marrëveshjen e parë dhe rikonfirmimin e asaj marrëveshje me nënshkrimet e subjekteve. Në këtë rast kjo nuk është rikonfirmim i marrëveshjes së parë, por është një urdhër që jepet, në këtë rast kryeministrit, se si duhet të veprojë gjatë qeverisjes të qenit e tij si kryeministër.

Unë do të dëshiroja shumë që kryeministri të ushtronte gjithë kompetencën dhe gjithë funksionin që e ka mbi bazë të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullores mbi institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, porse nuk është ashtu, tregon pikërisht kjo letër, që është një urdhër për kryeministrin. Ju lutem lexoni vetëm pikën e parë: Pajtohemi që ndoshta marrëveshja ka ekzistuar që ministri dhe zëvendësministri të jenë nga LDK-ja, por që nga LDK-ja të jenë edhe anëtarët e agjencive që do të vijnë nga Qeveria edhe të bordeve edhe të departamenteve nuk konsideroj se kjo është e përputhshme me asnjë marrëveshje tjetër dhe as me ligjet ekzistuese, sepse ne e dimë mënyrën si bëhet përzgjedhja e drejtuesve, bordeve dhe agjencive të ndryshme.

Që kryeministri nuk mund ta ushtrojë kompetencën e vet në bazë të kësaj letre tregon pika 2, sepse është i zhveshur, po them, se ndaj ministrave që vijnë nga LDK-ja përcjell punën dhe këtu si thuhet performacën e ministrave që vijnë nga LDK-ja dhe në qoftë se me këtë angazhohet tjetri në kuadër të Qeverisë ta përcjellë punën e ministrave nga LDK-ja. Unë konsideroj që kryeministri është i zhveshur nga kjo kompetencë dhe do të ishte shumë mirë edhe për opinionin edhe për atë që vërtet kompetencën ta ushtrojë deri në fund të na e thotë hapur dhe të na e thotë troç. E dimë entuziazmin e tij në fillim të punës, fillim të angazhimit të tij si kryeministër dhe premtimet që brenda një muaji ose brenda një qind dite do të dalë me qëndrimet rreth ministrave dhe punës së tyre dhe pastaj se si kjo çështje u la në harresë edhe përkundër asaj që u tha këtu nga diskutuesit e, tjerë raporteve të auditimit të brendshëm, të revizorit të përgjithshëm, e tjera për keqveprimin, keqmenaxhimin e fondeve të Kosovës.

Se është kjo një urdhër nuk do koment absolutisht. Këtë do të duhej të na e thoshte kryeministri, sepse jam i bindur se nuk e ushtron kompetencën e vet si kryeministër.

KRYESUESI – Ju faleminderit z. deputetë, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, Kaloshi, unë mendova të përfundojmë, por vazhdimisht po lajmërohen deputetë për fjalë, ju lus, ta bëj pasqyrën e lajmërimeve për debat. Fjalën e ka Hydajet Hyseni,

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit, z. kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë.

Duke ju përshëndetur të gjithëve ju më lejoni që veçanërisht ta përshëndes kësaj radhe kryeministrin dhe ta përshëndes edhe fjalën e tij. Megjithatë unë dua të them se letrat që po diskutojmë sot mua nuk më kanë befasuar fare, nëse ju kujtohet edhe me rastin e zgjedhjes së kryeministrit, unë kam pasë deklaruar afërsisht se për zotin Agim Çeku kandidat për kryeministër, për arsyet që dihen e i merrni me mend. Unë do të votoja pa asnjë hezitim, por kam shprehur drojën se zoti Agim Çeku, me gjithë kapitalin e tij politik ,po hynte në një lojë të tjetërkujt. Natyrisht e them sinqerisht kam dashur që të mos më dalë ashtu. Megjithatë edhe letra që po diskutojmë sot vetëm ma shton bindjen se kjo është e vërtetë . Nuk e kam fjalën këtu për ato që mund të quhen dhe u vlerësoan si çështje të brendshme të koalicionit vetëqeverisës.

Nuk e kam fjalën për zgjedhjen e pazaret e për postet ministrore, o.k. Mund edhe të jetë çështje e brendshme e koalicionit, nuk e kam fjalën as për performancat e raportin midis performancave të ministrave, zëvendësministrit që po ashtu mund të jetë edhe çështje e brendshme e koalicionit. Por e kam deri diku fjalën për çështjet si ato që kanë të bëjnë me rregullimin e allishveresheve e bordeve të agjensioneve rregullative që nuk mund të jenë vetëm çështje e koalicionit qeverisës, ose e përfaqësimit të Kosovës jashtë, që sigurisht nuk mund të jenë vetëm çështje të koalicionit qeverisës. Zonja dhe zotërinj do të dëshiroja ta përqendroja vëmendjen tuaj se nuk mund të jetë askush indiferent ndaj përpjekjes për ta konsideruar çështje të brendshme të koalicionit qeverisës edhe atë që është quajtur si proces i rëndësishëm për zhvillimet në Kosovë, që lidhen edhe me negociatat për status ,siç është bërë zakon të quhet e gjithmonë thuhet gabim.Ky proces u dashka të udhëhiqej ekskluzivisht nga LDK-ja, në koordinim të plotë për t'i dhënë pak sheqer aleancës me AAK-në.

Zonja dhe zotërinj kjo e fundit sidomos meriton vëmendjen e gjithëve neve, pse e bëme atëherë Ekipin e Unitetit? Pse flasim e çirremi aq shumë për unitetin, nëse nuk i duhet Kosovës uniteti në çështje të tilla madhore, pse atëherë këto standarde të dyfishta ose njëra ose tjetra? Ku është pjesa tjetër e jetës politike në Kosovë ? Dhe çka do të thotë kjo për imazhin e Qeverisë? Zoti kryeministër unë përpiqem ta kuptojë pozitën tuaj, megjithatë një përgjigje besoj që do të bënte mirë, a do të ishte më mirë që në këto proceset e rëndësishme që janë jo vetëm vendimtare për Kosovën, por edhe më shumë se kaq, që ne të kishim unitet edhe më të fortë edhe institucional edhe qeverisës, që të kishim një Qeveri të unitetit të gjerë, që do të ishte edhe profesionale. por edhe që do sintetizonte të gjithë energjitë tek ato çështje të mëdha që na bashkojnë. Ju faleminderit.

KRYESUESI – Ju faleminderit zoti deputet. Për fjalë janë lajmëruar edhe dy deputetë, por paraqiten edhe të tjerë, por më lejoni t'ju them se sot është 21 shtatori Dita Ndërkombëtare e Paqes. Në hollin e Kuvendit të Kosovës, në orën 12 do të mbahet një manifestim për nder të kësaj dite i organizuar nga presidenca e Kosovës, nga Kuvendi i Kosovës, UNMIK-u dhe i përkrahur nga OSBE-ja.

Jemi informuar se të gjithë deputetët kanë marrë ftesë për këtë manifestim, prandaj për hir të pjesëmarrjes në këtë manifestim, më lejoni të jap pauzë deri në orë 13 dhe të vazhdojmë pastaj me debatin. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ftoj deputetët që nuk janë në sallë të vinë sa më shpejtë ju lutem, të fillojmë me punë.

Lus deputetë t'i zënë vendet e tyre, do të fillojmë me punë.
Vazhdojmë me punë.

Ftoj deputetin Fetah Berisha ta marrë fjalën.

DEPUTETU FETAH BERISHA – Faleminderit z. kryetar, i nderuari kryeministër, ministra të nderuar kolegë.

Është për t'u përshëndetur gatishmëria z. kryeministrit Çeku që vjen plotë energji këtu para Parlamentit dhe i shpjegon gjërat ashtu si janë. Të kthehemi pak prapa nëse na kujtohet kur këtu në këtë parlament është zgjedhur z. Çeku kryeministër kanë filluar sulmet kundër tij ende pa votuar Parlamenti për të. Bile atëherë disa diskutues patën thënë: Po ndalni burra ta votojmë një herë, e le të jetë i zgjedhur legjitim e ka kohë edhe atëherë kur do të vijë në interpelancë ose kur do ta paraqet edhe planin e Qeverisë dhe do t'i diskutojmë këto gjëra. Pra këtu u tha çfarë u tha, po u tha edhe kjo, atau i LDK-ës kundër institucioneve, jo në asnjë mënyrë jo, LDK-ja nuk ka bërë kurrë atak ndaj askujt, aq më pak kundër institucioneve, sepse ajo ka krijuar institucione, di të krijojë institucione edhe atëherë kur robëria mbi kokat tona kishte arritur kulmin.

Edhe nga diskutimet u pa se ndoshta kërkesa për këtë interpelancë ishte atak dhe një brengosje shumë e madhe për koalicionin që është stabil. Por edhe nga diskutimet na doli kjo, se është një shqetësim pse po shkojnë punët mirë në Qeveri dhe pse po shkojnë mirë punët me koalicionin. Prandaj duhet kuptuar një herë e gjithmonë se renditja e punëve brenda koalicionin është ekskluzivisht punë e koalicionit. Pastaj u kuptua se ndoshta u bë edhe një tentim për të krijuar destabilitet, qoftë parlamentar apo krizë qeveritare.

Ju lutem kujt i duhen këto sot, kur në këtë vit flitet vazhdimisht për pavarësinë e Kosovës. Unë mendoj se më së paku kemi nevojë për to. Prandaj, fare në fund e përgëzoj funksionimin e mirë të koalicionit, punën e mirë dhe dinamike të Qeverisë e në veçanti të kryeministrit Çeku, sepse ndoshta edhe kësaj pak i vjen era „mos paq punë luaje derën.“ Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, urdhëroni profesor.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvendi i nderuar, z. kryetar.

Me vëmendje pak e shumë të koncentrueme e kam përcjellë diskutimin lidhur me këtë çështje. Njeriu fiton bindje se me qëllim a pa qëllim simplifikohet, thjeshtësohet mos me thanë edhe kamuflohen përmbajtja e letrës, porosia që del prej saj, shkakun se: po paraqitet një tendencë dominuese gjatë këtij diskutimi me e shndërrua një letër si komunikim të natyrshëm mes partnerëve të koalicionit. Kjo nuk qëndron kurrësesi, kishte me qenë kështu sikur letra e z. kryesuesit të LDK-ës t'u ishte drejtuar kryesuesit apo kryetarit të AAK-ës. Derisa nuk është kështu, atëherë nuk është komunikim. Letra e dërguar drejtpërdrejt kryeministrit, e ka porosinë e vet. Ajo është bërë publike, është mbërrirë efekti i saj negativ, për atë edhe këtu diskutimet duhet me u orientuar kah ai relacion i subjektit politik me kryeministrin. E përmend emrin e kryeministrit **pedoeja** e zotërisë është për t'u përshëndetur, e gëzon admirimin e secilit prej nesh. Por kjo përpjekje kështu me

zëvendësua tezën e me nxjerrë një konkludim sofizmit që në popull kishte me qenë me i qitë pluhur syve, por ajo nuk i ka hije këtij Kuvendi. Këtij Kuvendi i ka hije me u përqendrua në relacionin e asaj letre që ka sjellë implikime të shumta. Një njeri me sjellje, me veprim apo me një mendim me dashje apo pa dashje, kur është e paqëlluar as njëqind të mençur nuk mund me e sanua efektin e saj negativ. Kësisoj është edhe letra e kryesuesit të LDK-ës drejtuar kryeministrit. Është një pamje jo e hijshme edhe në Kuvend nëse përpiqemi me i gjetë ndonjë argument për me e arsytua këtë letër- përmbajtjen e saj. Kaq. Faleminderit.

KRAETARI – Ju faleminderit prof., fjalën e ka prof. Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar, z. kryeministër, kolegë të nderuar. Unë edhe në mbledhjen e Kryesisë kam shprehë një rezervë çfarëdo të prodhonte ky diskutimi ynë rreth një letre që LDK-ja ia ka dërguar partnerit të vet në qeverisje, por meqë një grup i madh parlamentar e ka kërkuar një shpjegim në nivel të Kuvendit, unë e kam akseptuar dhe sot për sot këtu dëgjova paraqitjen e kryeministrit dhe të kolegëve deputetë të PDK-ës dhe të tjerëve dhe konsideroj se këtu nuk ka nevojë shumë të shpjegohet tekstualisht një letër, e cila prodhon që të krijohet një disiplinë e marrëveshjes së një koalicioni qeveritar dhe në këtë kuptim mua më duket që edhe diskutimet në publik qysh bëhen zakonisht te ne para se të bëhen institucione i kanë shterrë të gjitha format, mënyrën e interpretimit të saj të mirë a të keq, të saktë apo të pasaktë. Pra unë e konsideroj veprim më normal të mundshëm që dy partnerët e koalicionit të përpiqen të diskutojnë dhe të precizojnë punën e tyre të përbashkët në qeverisje.

Kur kem parasysh këtë vetëm dua të theksoj që kjo më duket shumë e natyrshme dhe e zakonshme, sepse ne kemi Çekun një kryeministër të Qeverisë së Kosovës që është prodhim i një koalicioni, tripartitsh dhe është shumë normale që në faza të ndryshme, po them në mënyrë permanente të ketë konsultime rreth punëve të qeverisjes. Qeverisja u shërben popullit qytetarëve, por megjithatë në një sistem demokratik pluralist, qysh pretendon ta ketë Kosova në të cilën ka edhe pozitë edhe opozitë, qeverisja është e obligueshme ta realizojë një program qeverisës, me të cilin ka dalë para këtij parlamenti dhe i ka marrë votat. Kjo është prapë mënyra më normale e komunikimit dhe e kontrollit. Qeverisjen, pra të Kosovës në këtë rast, duhet ta kontrollojë në kuptimin e mirë të fjalës, më së pari shumica ose koalicioni qeverisës dhe në rend të dytë edhe opozita. Unë këtu nuk shoh kurrfarë mosmarrëveshje në veprime. Pra, këtë veprim unë e konsideroj veprim të rritjes së përgjegjësisë, asgjë më shumë, asgjë më pak. Interpretimet e tipeve kryeministri kontrollon këta ministra, ministri tjetër, kjo s'do të thotë gjë, është e natyrshme që eksponenti më i madh i partnerit të madh të koalicionit është kryeministri dhe është krejt normale që atij vetvetiu i bie puna të jetë eksponenti kryesor në atë qeveri, i partnerit të madh të koalicionit. Mirëpo kërkush nuk mund t'ia mohojë të drejtën edhe zëvendëskryeministrit që të **shkojë** permanencat e të gjithë ministrave ashtu, siç e deklaroi këtu kryeministri Çeku, që është e drejta dhe detyra e tij që ta shohë të ashtuquajtur permanencë të të gjithë ministrave ose t'i themi shqip ta përcjellë punën e tyre konkrete.

Prandaj, unë pas një fjalimi shumë të qartë të kryeministrit dhe atyre që i dëgjova këtu unë mendoj që kjo interpelancë i ka sqaruar të gjitha problemet dhe nuk ka nevojë të tëhollohet më tepër. Faleminderit.

KRSYETARI – Ju faleminderit. Gjergj Dedaj, e ka fjalën.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë z. kryetar.

Atë ditë kur është zgjedhur z. Çeku kryeministër, Grupi për Integrim ka abstenuar dhe pata bërë një krahasim ndoshta jo fortë të mirë, thashë “ Ju jeni një pilot i mirë i një aeroplani defekt”. Nuk është krejt defekti as kur ky debati,as kjo interpelancë nuk e ka të drejtë qëllimin që ta vë në shënjestër të kritikave kryeministrin Çeku ,sepse ne i dimë kontributin dhe rolin e tij. Sa është me rëndësi t’ia përkujtojmë koalicionit **vetëqeverisës** edhe hiç të mos ofendohen se kjo është një Qeveri e dështume. Them se është një Qeveri e dështume edhe e argumentoj vetëm merrni zonja dhe zotërinj titujt e gazetave gjatë fushatës zgjedhore 2004 çfarë ka premtuar koalicioni qeverisës dhe shikoni prej atyre premtimeve ati katalogu shumë të gjanë premtimeve kisha pas dëshirë që kryeministri në fut të fjalës së vet të na tregon vetëm cilin premtim e ka përmbushë kjo Qeveri; dhe ky duhet me qenë mesazhi i këtij debati edhe pse kam mendimin tim se këto debate dhe këto interpelanca u janë pak sa të mërzitshme më shumë po shfrytëzohen për marketing politik, më shumë kanë efekte sipas mendimit tim shumë negative sepse në fund të këtyre debateve asnjëherë nuk po marrim asnjë vendim asnjë qëndrim, asnjë konkluzë asnjë votim dhe asnjë rekomandim. Këtë e bamë edhe në debatin për Universitetin dhe për decentralizimin, por edhe për raportimin e Grupit Negociator edhe sot edhe në debate të tjera. Në fund thuhet seanca u krye. Ditën e mire. Shihemi në seancën e ardhshme dhe deputetët do të fitojnë vetëm nga një mëditje më shumë se Kosova nuk mendoj se fiton nga këto debate.

Është me rëndësi të theksohet se falë statusit të Kosovës edhe falë procesit që është, po shpresojmë në fazën përfundimtare dhe në finalizimin e së drejtës të popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe për pavarësi që nuk ka alternativë, do me thanë kjo Qeveri mund të mbijetojë deri atë ditë kur njihet dhe të respektohet ky vullnet. Përndryshe po ju them kështu shumë haptas, pa qëllime ose pa ofendime ose merrni si të doni, se nuk po mërzitna shumë për atë punë do me thanë vetë u kisha pri protestuesve për me hy në disa kabinete të qeverive të disa ministrave edhe me i nxjerrë ata ministra përjashta .në mënyrë do me thanë shumë demokratike ,sepse kjo ndodh edhe në vendet shumë më demokratike . do me thanë ndodh edhe në vendet që kanë demokracinë parlamentare, demokraci qindvjeçare e pse jo të mos ndodhë edhe në Kosovë,nëse ministrat e caktuar i kanë privatizuar komplet resorët e caktuara të Qeverisë edhe sillen sikur me ua pas lënë baba amanet

KRYETARI – Gjergj vetëm një çështje, e keni shfrytëzuar kohën që e keni pasë si grupet parlamentare. Megjithatë jua dhashë fjalën,

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Mirë z. kryetar, çka po thua, çka me ba unë tash, sinqerisht

KRYETARI – Unë thashë shumë qartë.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – A ke dëshirë me ndërpre?

KRYETARI – Shumë qartë po them

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ - Ta plotësoj dëshirën menjëherë. Faleminderit shumë edhe një herë po përfundoj” Kjo është Qeveria që do të mbahet mend gjithmonë për dështime”. Faleminderit shumë.

KRYETARI – E njëjta gjë vlen edhe për dr. Ferid Aganin .Është shfrytëzuar koha që ka qenë e paraparë. Ia jap fjalën propozuesit të interpelancës. Ju flisni si anëtarë i Grupit Parlamentar. Urdhëroni z. Krasniqi.

Ne po përpiqemi ta mbajmë rendin sipas fuqisë që e ka Grupi Parlamentar, ju e doni fjalën dhe unë do të doja t’ia jap fjalën, por, sipas Rregullores që e keni shfrytëzuar atë kohë që e keni si grup parlamentar. Unë po e them arsyen qartë, z. Krasniqi urdhëroni.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, i nderuari z. kryeministër.

E kam përcjell me vëmendje fjalën tuaj, përgjigjen tuaj në interpelancë dhe muj me thanë fillimisht më shtyn të them nëse është ashtu-ashtu është ,por nuk kemi marrë përgjigjen e duhur. Edhe një herë po jua përkujtoj pikën e parë të letrës.

Ministrat, zëvendësministrat, zyrtarët e lartë të agjencive të bordeve të departamenteve në të ardhmen të jenë të LDK-ës dhe unë po ju them nuk është problem kjo letër dhe ne letrën e kemi bërë vetëm si shkas, problemi është që kjo që thuhet në pikën 1. z. kryeministër është e realizueshme në gjithë Kabinetin Qeveritar, prej kryeministrit deri në agjensionet dhe departamentet. Z. kryeministër, opinionit nuk ia keni thënë të vërtetën gjithë sekretarët permanentë janë ose ushtrues detyre ose të pa konkurs, janë të përkohshëm dhe janë të paligjshëm, kur gjithë mandatin e kaluar gjithë sekretarët e përgjithshëm kanë qenë të zgjedhur me konkurs dhe mbi bazën e ligjeve. Kjo është shkelje e parë e madhe e ligjit që është bërë.

Z. kryetar,ju gjithashtu e dini se shkeljet pa konkurs. do të thotë janë bërë edhe në agjencionet e pavarura. Unë s’po t’i përmendi ,por ju duhet t’i dini, thuajse në të gjitha agjencionet e pavarura që do të duhej të ishin të pavarura nga ministrat, janë ushtrues të detyrës, janë zgjedhur pa konkurs. Kjo është e kundërligjshme dhe kjo është përgjegjësia e juaj z. kryeministër se ju jeni dhe e udhëhiqni **Klepin** Këshillin e lartë, këshillin për emërimet e larta, nuk e udhëheqin as ministrat, por e udhëheq kryeministri i Kosovës dhe ju në këtë rast nuk e keni ushtruar detyrën e juaj.

Z. kryeministër mundem me thanë që gjatë këtij mandati ,duke qenë qeverisja e keqe, buxheti i konsoliduar i Kosovës ka renë. Të ardhurat për kokë të banorit janë zvogëluar, sistemi i arsimit ka stagnim, nëse nuk ka renë nëse nuk ka denigruar, por stagnim dhe kjo nuk është e mirë për Kosovën, jo për Partinë Demokratike.

Administrata publike që ju e udhëhiqni z. kryeministër është e paaftë, është joprofesionale, ajo nuk punon asgjë. Administrata publike në Qeverinë e Kosovës ,gjithë kabineti qeveritar luan letra në kompjuter, nuk bënë punë.

Z. kryeministër buxheti i Kosovës nuk është harxhuar sipas planifikimit, ministrat kanë harxhuar sipas qefeve të tyre dhe kjo është shkelje e rëndë. Kjo është vjedhje e buxhetit, kjo nuk është keqpërdorim, z. kryeministër është vjedhje e buxhetit. Krejt këto i keni toleruar ju. Tjetër, ju mbështetët shifat e grupeve më të mëdha ose të koalicionit. Është e vërtetë ajo është përgjegjësia e atyre le të mbështesin. Po po ju them, juve z. kryeministër

edhe Parlamentit, jeni duke e keqpërdorur statusin politik të Kosovës, jeni duke keqpërdorur se ne jemi pjesë e këtij procesi politik, po nëse dikush e ka dëmtuar dhe vazhdon ta dëmtonjë procesin politik për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran z. kryeministër janë ministrat që i udhëhiqni ju.

Ju i keni raportet e Auditorit Gjeneral, asnjë raport nuk e keni shikuar seriozisht dhe nuk e kenindërpritet.

KRYETARI – Ju faleminderit. Me kaq e përmbyll debatin rreth interpelancës dhe për pikën tjetër të rendit të ditës. Urdhëroni

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kolegë të nderuar.

Ne në fillim të seancës u morëm vesh për një deklaratë të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës janë marrë vesh për tekstin e kësaj deklarate dhe unë do t’jua lexoj formën e saj përfundimtare.

Kuvendi i Kosovës, në seancën plenare të datës 21 shtator 2006, lidhur me shpërthimet e fundit në Kosovë, lëshon këtë

DEKLARATË

1. Kuvendi i Kosovës dënon me forcë shpërthimet e ditëve të fundit në Gjilan, në Ferizaj e në Klinë, duke i konsideruar akte dhune e terrori që rrezikojnë jetën e njerëzve dhe krijojnë pasiguri në vend,
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga SHPK-ja, nga Policia e UNMIK-ut dhe nga përgjegjësit e tjerë të sigurisë në Kosovë, që kryesit e këtyre akteve të dhunës e të terrorit të nxirren para ligjit dhe t’i parandalojnë veprimet që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe
3. Kuvendi i Kosovës vlerëson që aktet e dhunës dhe të terrorit prishin pamjen e Kosovës para botës dhe dëmtojnë rënd politikisht procesin e pavarësimit të Kosovës.

Prishtinë, më 21 shtator 2006.
Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Votojmë kush është për:
Në sallë janë 70 deputetë. Votojmë tash:

Ju lutem regjia

Për 63;

Kundër 1.

Aprovohet deklarata e propozuar nga z. Hamiti. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Legjislativ për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë

Në pajtim me rregullat procedurale Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka shqyrtuar propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin për rekomandimet konkrete.

Janë dy raporte që janë paraqitur për këtë pikë të rendit të ditës. Propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës bashkë me biografite, me aplikacionet e kandidatëve si dhe raporti i Komisionit funksional, u janë shpërndarë të gjithë deputetëve me kohë.

Arsyetimin e raportit me rekomandimin në emër të Komisionit, nëse kërkojmë, mund ta shohë përfaqësuesi i Komisionit. Urdhëroni z. Berisha.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – I nderuar kryetar i Kuvendit, i respektuari kryeministër dhe ministra të nderuar, të nderuar kolegë deputetë.

Para nesh kemi dy rekomandime të bëra nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese e që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe rekomandimin e Këshillit Gjyqësor për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve publikë në institucionet e gjyqësisë dhe të prokurorisë së Kosovës.

Dy rekomandime që janë nxjerrë, një në mbledhjen e datës 8 shtator dhe rekomandimi vijues që është i datës 20 shtator që ka të bëjë me rishikimin e rekomandimit të mbledhjes së parë.

Kjo dëshmon se Komisioni me përgjithësi dhe kompetencë ka shqyrtuar rekomandimin e bërë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zgjedhjen, përkatësisht emërimin e gjyqtarëve, prokurorëve për këto institucione të rëndësishme së veçantë të Kosovës. Rezultat i kësaj pune është që Komisioni i rekomandon Kuvendit për emërim të këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve si vijon:

1. Agron Berisha, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Pejë,
2. Sahide Gashi, gjyqtare në Gjykatën Komunale në Pejë,
3. Agim Ademi, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan,
4. Vesel Ismaili, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë,
5. Driton Muharremi, Gjyqtar në Gjykatën Komunale- Prishtinë,
6. Naim Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën Komunale- Prishtinë,
7. Hasim Sogojeva-gjyqtar në Gjykatën komunale- Ferizaj,

8. Bashkim Hyseni gjyqtar në Gjykatën Komunale- Ferizaj,
9. Sadije Gërguri ,gjyqtare në Gjykatën Komunale në Mitrovicë,
10. Nenad Laziq ,gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë- dega Graçanicë,
11. Reshat Karaxha, gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje Prizren,
12. Radisha Vidosavljeviq, prokurore në Prokurorinë Komunale -Mitrovicë,
13. Dejan Miliq, gjyqtar në Gjykatën Komunale -Mitrovicë,
14. Ibrahim Rexhepi ,gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje -Prizren,
15. Edi Sezairi, gjyqtar në Gjykatën komunale Prizren,
16. Bilena Gjeriq gjyqtar në Gjykatën Komunale Mitrovicë dhe
17. Jasvorka Priliqeviq gjyqtare në Gjykatën Komunale Ferizaj, dega Shtërpçë.

Komisioni për Çështje Legjislative dhe Gjyqësore nuk ka dhënë rekomandimin për emërim në këtë takim Kuvendit për kandidatin Gjorgje Aksiq, që është rekomanduar për gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës, Vasilije Arsiq, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan, Veton Dërgutit për gjykatës në Gjykatën Komunale Rahovec, Samile Mushkolaj për gjykatëse në Gjykatën Komunale Gjakovë dhe Rrahman Asllani për gjykatës në Gjykatën komunale Prizren.

Arsyetimin për mosrekomandim e keni në shtojcën e rekomandimeve të miratuara me 20 shtator të këtij viti. Ju faleminderit!

I keni në rekomandime, nëse ka nevojë pse jo!

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Sadudin Berisha

DEPUTETI SADUDIN BERISHA - Nëse ka nevojë të keni rekomandime pse jo!

Komisioni nuk mbështet kandidaturën e kandidatit për gjyqtar në Gjykatën Supreme të Gjorgje Aksiqit, me arsyetimin e se: gjatë luftës në Kosovë në periudhën prej 25.03. 1999. deri me 15 qershor të vitit 1999. ka qenë i mobilizuar si zëvendësprokuror ushtarak pranë Komandës ushtarake të qarkut në Prishtinë dhe kërkon që Kuvendi i Kosovës, Komisioni të kërkojë informacion shtesë për të gjitha këto të dhëna të cilat janë të precizuara në dokumentacionin e plotësuar nga vetë kandidati. Arsyeja e mospranimit të kandidaturës së Vasilije Arsiqit është e mbështetur në aplikacionin kandidatit, sepse ai edhe pas instalimit të administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe institucioneve të Kosovës edhe më tej vazhdon të punojë në institucionet e instaluar paralele të Serbisë në Kosovë, pra punon në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë, në Sekretariatit e Punëve të Brendshme Gjilan.

Kandidati Veton Dërguti, gjithashtu i rekomanduar për gjyqëtar në Gjykatën e Rahovecit dhe kandidatja Samile Mushkolaj e rekomanduar për Gjyqëtare në Gjykatën Komunale në Gjakovë, nuk përkrahen me arsyetim se nuk e plotësojnë njërin nga kriteret e parapara në Rregulloren për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht mungon përvoja e mjaftueshme e punës prej 3. vjetësh. Përderisa për kandidatin Rrahman Asllani komisioni ka vlerësuar të mos jepet rekomandim për shkak se dyshohet se kemi të bëjmë me falsifikimin e dokumentit, ashtu siç është dhënë në shpjegimet e Komisionit. Këto janë arsyet e gjithë këtyre rekomandimeve. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e kërkon deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Zoti kryetar, grupi parlamentar i Partisë demokratike e ka parë me kujdes propozimin e Këshillit gjyqësor për emërimin e disa gjyqtarëve.

Për gjyqtarët e ofruar nuk kemi të dhëna të mjaftueshme, pastaj ka shumë nga këta që nuk e meritojnë të ushtrojnë detyrën e gjyqtarit. Në sistemin e drejtësisë jo vetëm këta që na ofrohen janë instaluar prokurorë dhe gjyqtarë që në të kaluarën e afërt kanë marrë pjesë në gjykime politike, për të mos thënë edhe kriminale, njerëz që hetimet ia kanë lejuar policisë politike, sekrete serbe për të ushtruar dhunë psikike dhe fizike. Ka edhe në këtë sallë që me vite kanë qenë viktimë të gjykimeve të padrejta, midis tyre është ushtruar dhunë fizike.

Ne nuk besojmë se gjyqtarët e tillë mund të jenë perspektiva e drejtësisë së Kosovës. Ne kemi rezerva të shumta për këtë listë, por jo vetëm për këtë. Vërejtjet tona shkojnë më tej dhe kanë të bëjnë me gjithë sistemin e drejtësisë së është hetuar të ngritet gjatë këtyre viteve në Kosovë. Ka defekte të shumta që kanë përcjellur dhe vazhdojnë ta përcjellin drejtësinë tonë, siç janë: mungesa e profesionalizmit, politizimi i skajshëm, paaftësia, vartësia dhe jo-gatishmëria për t'u përballur me problemet e kohës, me korrupsionin dhe me ngarkesat që i bartin nga sistemi i kaluar kur gjyqtarët dhe prokurorët janë udhëhequr nga vendimet politike dhe policore.

Ne mendojmë se praktika e deritashme e emërimit të gjykatësve duhet të ndërpritet. Jo edhe aq për shkak të së kaluarës, e cila nuk është e pa-rëndësishme sa për hir të ndërtimit të sistemit të drejtësisë sot. Sistemi i drejtësisë, i ri i drejtësisë duhet të bëhet nga njerëzit e rinj që janë krijuar si gjyqtar dhe gjatë këtyre viteve pas Luftës Çlirimtare të Kosovës.

Kjo duhet të ndodhë edhe për faktin se gjatë këtyre viteve ky sistem nuk ka arritur ta zbulojë asnjë vepër kriminale të krimeve të rënda të natyrës politike dhe ekonomike. Suksesi i vetëm i sistemit të drejtësisë ka qenë dënimi i atyre që është dashur të shpërbleheshin nga institucionet e reja të Kosovës, por që nuk ka ndodhur ende kjo gjë. Ky sistem, kështu si është, zor se do të jetë njëri nga segmentet që do ta shtojë sigurinë e qytetarëve në Kosovë. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është për një sistem ndryshe të drejtësisë, për një sistem të reformuar, të përbërë nga gjyqtarë profesionistë të papolitizuar, të paanshëm, të pakorruptueshëm, të përgjegjshëm dhe të vendosur për të kryer detyrën e vet tepër të rëndësishme për një shoqëri që i duhet të kapërcejë dy transicione.

Njëherish: tranzicionin nga mentaliteti i robit dhe nga mentaliteti i njeriut të lirë dhe nga shoqëria e mendësisë totalitare, në atë të mendësisë demokratike. Në këtë rrafsh kemi vështirësi serioze edhe ne, të zgjedhurit e popullit që po e përfaqësojmë atë. Ne këtë nuk e bëjmë se po dëshirojmë të diferencohemi, ne nuk dëshirojmë ta kemi për pasqyrë të së ardhmes të kaluarën e hidhur, ku jemi diferencuar, dënuar dhe denigruar skajshmërisht. Pikësynimi ynë është ndërtimi i sistemit të drejtësisë së pavarur, profesional, efikas, jopolitik, të pa korruptueshëm, të autoritetshëm, të besueshëm dhe transparent para qytetarëve. Ne besojmë se në Kosovë ka mjaft gjyqtarë të rinj në të gjitha komunitetet, si nga shumica ashtu edhe nga pakica. Vota jonë është kundër kësaj liste të ofruar edhe pse aty ka njerëz të mirë. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI - I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mund të pranojë debat lidhur me sistemin e gjyqësisë, kurdo që të jetë e nevojshme, qoftë ai propozim nga opozita, apo edhe ndonjë debat i cili

mund të incizohet nga institucionet e tjera të vendit tonë. Por ne sot, z. kryetar, e kemi në rend të ditës një rekomandim të Komisionit tonë për Çështje Gjyqësore relative, që bie në bazë të gjithëve se ka bërë gjyqi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për të cilin ne si grup parlamentar kemi kërkesë të jetë shumë më azhur dhe të punojë sa më shumë që të jetë e mundshme, që të dërgojë propozime të mbështetura me fakte, që numri i gjyqtarëve të emëruar të jetë në kualitet dhe në numër sipas standardeve të kohës në të cilën ne jetojmë. Ne si grup e kemi shqyrtua këtë rekomandim të Komisionit dhe e mbështesim Komisionin me rekomandimet e veta dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë në votim, lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit zoti kryetar!.

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla,

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Ju faleminderit zoti kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet rekomandimin e Komisionit dhe do t'i votojmë të gjithë ata që janë propozua në bazë të rekomandimit të Komisionit. Po ashtu mbështesim rekomandimin e Komisionit lidhur me informata shtesë, për kandidatët të cilët nuk i ka mbështetur Komisioni. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI - Ju faleminderit zoti kryetar. Ne në Komision kemi diskutuar gjerë e gjatë lidhur me rekomandimin nga Këshilli Gjyqësor Prokurorial, sigurisht që informacionet që kemi pasur nuk kanë qenë të bollshme. Më duhet të them këtu para jush dhe në mungesë të informacioneve të mjaftueshme, për individët e kandiduar ne kemi marrë vendimin ashtu siç e kemi parë të arsyeshme në Komision. Më duhet për saktësi para seancës, ta saktësoj një, ndoshta një shkarje, një lëshim që e bëri kolegu im nga Komisioni, Sadudini. Ai dha me saktësi të plotë emrat e të gjithë atyre që e kanë marrë rekomandimin e Komisionit, i dha edhe emrat e atyre që nuk i kanë marrë atë rekomandim nga Komisioni, po tek arsyetimi i zotit Rrahman Asllani, nuk e përmendi se ai nuk është personi që është supozuar që ka pa- rregullsi në dokumentacion dhe jo vetëm Dërguti, siç e tha. Për këtë vetëm kjo është saktësia, nuk është vetëm Dërguti ai që është supozuar për falsifikim, po është Rrahman Asllani, ai që është supozuar dhe kërkohen informacione shtesë.

Këtë desha ta saktësoja. Ju faleminderit:

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka Sadudin Berisha, - replikë,

DEPUTETI SADUDIN BERISHA - Nuk është çështje që duhet të replikohet, po unë shumë qartë e thashë se dy kandidatët nga komisioni Veton Dërguti dhe Samile Mushkolaj nuk kanë pasur mbështetje nga Komisioni, për shkak të mosplotësimit të njërit nga kushtet e parapara në Rregulloren për themelimin e Këshillit Gjyqësor, përkatësisht të mungesës së përvojës së punës prej 3 vjetësh. Përderisa për kandidatin në vijim, Rrahman Asllani, sipas vlerësimit të Komisionit ekziston dyshimi i bazuar se kemi të bëjmë me falsifikim të dokumenteve, të cilat kanë qenë përcjellë në Komision. Ju faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, përgatitet deputeti Gani Koci,

DEPUTETI BERAT LUZHA - Ju faleminderit zoti kryetar. Unë kam disa vërejtje të cilat Komisioni ose nuk i ka parë, ose nuk ka dashtë t'i shohë, te kandidatura e Javorka Petroviqit, shkruan saktë se ka qenë sekretare e Këshillit Ekzekutiv të Kosovë e Metohisë dhe punëdhënës e ka pasë Zoran Angjellkolviqin gjatë viteve 1999-2000, do të thotë ka qenë në strukturat paralele. Pas luftës Dejan Miliqi, aplikon. Aty ku kërkohen të dhëna për shërbimin ushtarak, e ka plotësuar në mënyrë provokative, "Vojna tajna". Mendoj që edhe Komisioni e ka provokuar Kuvendin, derisa e ka kaluar këtë person, i cili nuk ka shpjeguar se vërtet çka ka qenë në ushtri, a ka krye ushtri, apo çka ka qenë, unë nuk mund ta di se vërtet çka fshihet mbas tij dhe pas asaj "vojna tajna" të tij. Te Reshat Karaxha unë kam biseduar me njerëz kompetentë në Prizren, të cilët kanë thënë se ai nuk ka cilësi as njerëzore dhe lere më profesionale etj. Ai është përjashtuar shumë herë nga puna, por asnjëherë nuk është përjashtuar mbi baza politike.
Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Koci,

DEPUTETI GANI KOCI - Ju faleminderit zoti kryetar Unë nuk do të merrem me emra, sepse u tha shumëçka këtu dhe nuk dua ta përsëris atë, jam edhe anëtar i Komisionit për Ankesa dhe Parashitja dhe si nënkomision e kemi shqyrtuar edhe një shkresë të dërguar nga një grup kandidatësh ose aplikuesish për gjyqtarë për mënyrën se si janë bërë përzgjedhjet në Këshillin Gjyqësor të këtyre kandidatëve dhe konstatimet e tyre kanë qenë të atilla që vërtet Këshilli Prokural, Këshilli Gjyqësor, nuk e kanë kryer me profesionalizëm dhe me kompetencë punën në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve, në bazë të konkursit të shpallur të vitit 2005. më 28.02.2005. ne si nënkomision nuk kemi mundur, nuk kemi pasë kompetencë të rikthejmë këtë përpos asaj që i kemi rekomanduar Këshillit Gjyqësor që të shikojë dhe të rishikojë edhe një herë, me përpikëri mënyrën, kriteret dhe respektimin e konkursit në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve.

Ajo çka është befasuese, pikërisht pse veprohet kështu, kemi edhe një sistem të tillë gjyqësor, me formularin që vjen prej Këshillit Prokural Gjyqësor në një rubrikë ku shkruan hetimet mbi të kaluarën, nuk kemi asnjë të dhënë për asnjë nga aplikuesit, se cila ishte e kaluara e tyre profesionale, morale dhe politike, por shkruan vetëm se aplikuesi ka kaluar dhe unë jam i bindur shumë se Këshilli Prokural, Këshilli Gjyqësor nuk i kanë shfletuar këto materiale kaq të shumta edhe aq të zbraza, se sikur t'i kishte shfletuar, nuk do të na sillte një listë të tillë, por do të kërkonte dhe do të vepronte mbi bazë të kompetencës që e kanë, aq më tepër Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, po ashtu jam i bindur se paraprakisht nuk ka shfletuar gjithë dokumentacionin, sepse edhe rekomandimet do të ishin të tjera dhe nuk do të na vinin brenda tri katër dite, dy forma ose dy lloje të rekomandimeve.

Një gjë është më se e sigurt, ne sikur po dëshirojmë vet të riinstalojmë njerëzit, të cilët në të kaluarën kanë keqpërdorur pozitën e tyre, kanë nxjerrë vendime jo gjyqësore, por politike dhe kjo neve duhet të na kushtojë në të ardhmen. Nuk mund të pajtohemi me atë që dje më ke dënuar mua, po supezoj babai i gjyqtarit të sotëm, sepse ai nesër do ta dënojë edhe birin tim. Vetë fakti që ka njerëz këtu që viteve 97 – 98 dhe 99, kanë qenë në struktura të

okupatorit serb dhe kanë kaluar nëpër këto dy institucione, tregon për pa-përgjegjësinë edhe të Këshilli Prokural Gjyqësor edhe të vetë Komisionit të Kuvendit për Legjislacion. Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - Ju faleminderit zoti kryetar. Besoj pas këtij debati nuk do të më shtrohet mua ndonjë pyetje jashtë teme, meqë do të lirohem të flas edhe unë jashtë agjendës.

Megjithatë, unë desha vetëm të sqaroj, eventualisht ndonjë segment që mund të jetë i paqartë.

Së pari ky Kuvend duhet të ketë parasysh se në këtë fushë ne ndodhemi në gjendje shumë të veçantë, shumë specifike, kjo fushë ende konsiderohet e rezervuar, ende funksionohet me akte normative që janë sjellë nga Përfaqësuesi Special. Në rrjedhë është procesi i bartjes së kompetencave, ndërtimi i sistemit të drejtësisë, konsolidimi i tij dhe përgatitjet për transformimin e tij. Ky proces zonja dhe zotërinj, do të zgjatë gjatë. Prandaj këtu sjellim shumëçka tjetër, ndodhemi midis asaj porosie që e ka thënë shumë kohë më parë dikush.: Zot, më jep fuqi ta kundërshtoj gjithçka që duhet kundërshtuar. Më jep durim që të pranoj gjithçka që duhet pranuar, dhe më jepë mençuri që t'i dalloj këtu të dya." Komisioni në situatën e dhënë ka bërë përpjekje që pikërisht të gjendet midis këtyre dy nevojave.

Zonja e zotërinj, siç është konstatuar në shumë raporte, në gjyqësorin e Kosovës ka shumë mangësi ka edhe mangësi gjyqtarësh dhe prokurorësh, prandaj është nevojë e pashtyeshme, plotësimi i vendeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Më mirë është lëndët që presin të zgjidhen dhe nuk mund të zgjidhen me këta gjykatës që janë. Përveç tjerash, struktura etnike e gjyqtarëve nuk është në përputhje me përcaktimet tona dhe me aktet me të cilat funksionojmë, prandaj është e nevojshme, po ashtu, të përmirësohet struktura etnike. Propozimi i Departamentit të Drejtësisë, që ende është i rezervuar dhe Këshilli Gjyqësor që është ashtu kështu i përzier, ka qenë që në këtë valë të ketë vetëm përfaqësues të pakicave kombëtare dhe kryesisht të një komuniteti.

Megjithatë, me angazhimin në Këshill është siguruar përbërja e përzier, sepse edhe nga radhët e gjykatësve shqiptarë ka shumë nevojë për gjykatës të rinj. Procedura e zgjedhjes është ajo që është dhe ju i keni aktet, ne nuk mund t'i ndryshojmë ato. Nuk është më e mira, do të ketë edhe shumë lëshime edhe të tillë që nuk meritojnë. Do të mund edhe të refuzohet ndonjë që meriton ndoshta, megjithatë, me këtë nuk përfundon procesi i verifikimit të gjykatësve. Unë dëshiroj ta informoj edhe Kuvendin edhe opinionin se Këshilli Gjyqësor dhe partnerët që punojnë, janë në përgatitje të projektit për verifikimin e gjithë strukturës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këtij procesi do t'i nënshtrohen të gjithë pa dallim dhe ai do të jetë një rast, pastaj edhe për të korrigjuar eventualisht ndonjë inkonsekuencë.

Ajo që mund të bëjë Kuvendi është që tani të kërkojë informacion shtesë për ata që konsideron se nuk ka pëlqim të mjaftueshëm, eventualisht edhe t'i kundërshtojë ata për të cilët ka arsye të mjaftueshme për t'i kundërshtuar. Komisioni është përcaktuar pas dy- tri shqyrtimeve që i kemi pasur për rekomandimet që u dhanë nga zoti Berisha, zëvendëskryetar i Komisionit. Unë mendoj se ky Kuvend do ta kryejë detyrën e vet, duke votuar rekomandimet e Komisionit.

Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit, pasi nuk ka të interesuar të tjerë për debat, lus deputetët të përgatiten për votim

Listën që e propozon Sadudin Berisha, sipas rekomandimeve që i dhamë.

Votojmë tash:

PËR:42 vota
KUNDËR:.....26 vota.

Kalon propozimi, konstatoj se në sallë janë 77 deputeë,

E kemi edhe pikën e fundit të rendit të ditës,

Kërkesa e Grupit 6+ për amendamentin për gjuhën.

E hedhë në votim: Kuvendi duhet të marrë vendim, me të cilin shfuqizohet vendimi nga seanca e 14 shtatorit 2006 dhe merret vendimi sipas rekomandimit të panelit, por është një votim, ne një votim d.m.th. e zhvlerësojmë vendimin e mëparshëm dhe marrim vendimin e ri tash.

Votojmë tash:

PËR59 vota,
KUNDËR..... 7 vota.

Kalon amendamenti.

Në sallë ishin 77. deputetë me rastin e votimit. Fjalën e ka kërkuar deputeti Mahir Yagcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGXHILLAR - Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë, dëshiroj t' ju falënderoj për përkrahjen. Falënderoj të gjithë grupet parlamentare, posaçërisht e falënderoj deputetët nga Prizreni, nga LDK-ja, nga PDK-ja dhe të tjerë dhe mendoj se sot Kuvendi i Kosovës ka treguar një përgjegjësi të lartë. Ishte një vërtetim se e ardhmja e Kosovës u takon të gjithëve, se Kosova duhet ta ketë statusin e vetë të pavarur. Javën e kaluar votimi ka qenë një befasi për Grupin e Kontaktit dhe për komunitetin tim, por sot ishte një kënaqësi.

Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit edhe juve.

Konsideroj se mbledhja mori fund.